Siguria e furnizimit: duke trajtuar varësinë në rritje të importit të energjisë nga BE nëpërmjet një qasjeje të integruar - duke reduktuar kërkesën, duke diversifikuar përzierjen energjetike të BE -së me përdorimin më të madh të energjisë konkurruese lokale dhe të ripërtëritshme. Gjithashtu duke diversifikuar burimet e prodhimit, duke krijuar klimën e cila do të stimulojë investimet adekuate për të përmbushur kërkesën në rritje të energjisë, pajisjen më të mirë të BE-së për të përballuar emergjencat, përmirësimin e kushteve për kompanitë evropiane që kërkojnë qasje në burimet globale dhe duke siguruar që të gjithë qytetarët dhe bizneset të kenë orientim në tregun energjetik. Prandaj, analiza empirike mbi lidhjen shkakore midis konsumit të energjisë elektrike dhe rritjes ekonomike duket të jetë veçanërisht e rëndësishme pasi, sapo të kontrollojmë për luhatjet e çmimeve, programet optimale për zhvillimin e

²³ Sala, 2012, p. 91.

²⁴ Ibid.

tregut energjetik si pjesë e zhvillimit të qëndrueshëm, përfshijnë konkluzionet e Dokumentit të Gjelbër. Nëse konsumi i energjisë elektrike shkakton rritje ekonomike, atëherë politikat që nxisin një konsumin e energjisë elektrike do të kenë një ndikim në rritje. Nëse konsumi i energjisë elektrike nuk shkakton rritje ekonomike, por rritja ekonomike rrit konsumin e energjisë elektrike, atëherë politikat për konservimin e energjisë elektrike nuk do të kenë ndikim në rritje. Nga ana tjetër, nëse kjo e fundit është e vërtetë, me rritjen ekonomike do të ndodhë edhe rritja e konsumit të energjisë elektrike, duke sinjalizuar nevojën për rritjen e prodhimit të energjisë.²⁵

2.2. HULUMTIME RELEVANTE PËR EFIÇIENCËN E ENERGJIS ELEKTRIKE

Narayan dhe Prasad kanë ekzaminuar lidhjen shkakësore midis konsumit të energjisë elektrike dhe rritjes ekonomike mbi 38 vende të OECD. Nëpërmjet testit të shkakësisë Granger, ata treguan se konsumi i energjisë elektrike shkakton rritje ekonomike në rastin e Australisë, Islandës, Italisë, Republikës Sllovaqe, Republikës Çeke, Koresë, Portugalisë dhe Mbretërisë së Bashkuar. Evidencat provonin neutralitet të kësaj lidhjeje për vende të tjera. Në mënyrë të ngjashme, Böhm kreu një studim për të hetuar mbi kointegrimin dhe shkakësinë midis konsumit të energjisë elektrike dhe rritjes ekonomike. Rezultatet treguan një lidhje shkakësore të njëanshme midis konsumit të energjisë elektrike dhe rritjes ekonomike në Belgjikë, Greqi, Itali dhe Holandë, ndërkohë që lidhja rezultoi e kundërt në Irlandë, Portugali dhe Spanjë. Autorët konkludojnë se konsumi i energjisë elektrike ka ndikim në rritjen ekonomike, edhe pse lidhja mund të paraqitet si endogjene. Studimet mbi lidhjen midis konsumit të energjisë elektrike dhe rritjes ekonomike janë të shumta. Studimet më të shumta rreth kësaj lidhjeje janë kryer për vendet aziatike.²⁶ Yoo zhvilloi një studim për të shqyrtuar marrëdhëniet shkakësore midis konsumit të energjisë elektrike dhe rritjes ekonomike për katër vendet e ASEAN-it²³, përkatësisht Indonezia, Malajzia, Singapori dhe Tailanda. Rezultatet empirike treguan se lidhja mes konsumit të energjisë elektrike dhe rritjes ekonomike ishte e dyanshme në Malajzi dhe Singapor. Nga ana tjetër, në Indonezi dhe Tailandë kjo lidhje u paraqit e njëanshme, nga ku rritja ekonomike ndikonte në konsumin e energjisë elektrike. Ndërkohë që studime të rëndësishme janë kryer edhe për vendet në tranzicion. Acaravci dhe Ozturk shqyrtuan marrëdhënien midis konsumit të energjisë elektrike në vendet e Europës Lindore dhe disa vende të Ballkanit, përfshirë edhe Kosovën, për vitin 1990 – 2006. Analiza e kointegrimit u krye për të dhënat panel (të agreguara), kështu që nuk u paraqitën rezultate në bazë vendesh. Megjithatë, analiza e kointegrimit nuk paraqiti ndonjë lidhje të rëndësishme shkakësore midis konsumit të energjisë elektrike dhe rritjes ekonomike në këto vende. Studimi konkludon duke sugjeruar mungesa e lidhjes vjen për shkak të problemeve që këto vende kanë pasur nga njëra ana me stabilitetin ekonomik dhe nga ana tjetër me tregun e energjisë elektrike.²⁷

²⁵ Shrestha, 2007, p. 45.

²⁶ Madlender, 2002, p. 135.

²⁷ Griffin, 2008, p. 210.

Gjithashtu, të njëjtët autorë, në një punim më të detajuar për Kosovën, Bullgarinë, Hungarinë dhe Rumaninë, në këtë rast me të dhëna nga viti 1980 – 2006, arrijnë po në të njëjtin konkluzion, duke mohuar një lidhje shkakësore midis tyre për këto vende. Nga ana tjetër, përveç lidhjes së konsumit të energjisë elektrike me rritjen, ekzistojnë edhe lidhje të tjera. Në këtë rast, studimet e shqyrtuara analizojnë anën e ofertës, pra ndikimin që ka energjia elektrike në prodhim. Teoritë e fundit të rritjes ekonomike, në mënyrë të veçantë ato të rritjes endogjene kanë theksuar rolin e madh të progresit teknologjik dhe të produktivitetit. Duke ruajtur këtë linjë, rritja e aksesueshmërisë drejt energjisë me cilësi të lartë, direkt dhe indirekt ndikon në produktivitetin e kapitalit fizik të zotëruar. Zhvillimet teknologjike kanë bërë që kapitali fizik i përdorur për të prodhuar të mira dhe për të siguruar shërbime, të përdorë në një masë më të lartë teknologjinë, e cila nga ana e vetë mishëron energjinë. Shumica e teknologjive të përdorura në prodhim përdorin energjinë elektrike si burim të tyre, dhe me përmirësimin e teknologjive, shtohet përdorimi (dhe nevoja) e energjisë elektrike. Kështu prodhimi përfundimtar mishëron një sasi më të madhe të energjisë, pikërisht mundësuar nga faktorët e prodhimit. Aksesueshmëria ndaj një cilësie më të mirë të energjisë elektrike lidhet edhe me një produktivitet më të lartë në punë, kjo pasi kapitali fizik (makineritë) ose teknologjik ka një rendiment më të lartë dhe gjithashtu amortizimi i tyre ndodh në një normë më të ulët. Për sa i përket vendeve në zhvillim, është vënë re një lidhje e rëndësishme midis qëndrueshmërisë së energjisë dhe stabilitetit ekonomik. Qëndrueshmëria energjetike, ka të bëjë me furnizimin e vazhdueshëm dhe të pandërprerë me energji nga njëra ana, dhe nga ana tjetër me furnizimin me energji cilësore. Shumë vende vuajnë përgjatë procesit të prodhimit për shkak të paqëndrueshmërisë së energjisë elektrike. Gjithashtu, vendet në zhvillim përdorin teknologji më pak të avancuara se vendet e zhvilluara, kjo bën që edhe amortizimi i tyre, në kushte të një energjie më pak cilësore, të ketë norma më të larta. Në këtë mënyrë produktiviteti i ulët dhe kjo sjell një ngadalësim të rritjes ekonomike. Debatet më të rëndësishme kohët e fundit janë orientuar drejt zhvillimit të qëndrueshëm. Një nga pikat kyçe të debatit ka të bëjë me energjinë. Tregu i energjisë, gjithmonë edhe më tepër po orientohet drejt energjisë elektrike, si burim i rinovueshëm dhe që nuk shkakton ndotje.²⁸

Studiuesit, po përpiqen të tregohen sa më të saktë në matjen e PBB – së, duke marrë parasysh edhe dëmin që, përgjatë prodhimit, i shkaktohet mjedisit. Ky mendohet të konsiderohet si “amortizim”, i njëjtë me atë që i ndodh kapitalit fizik, megjithatë shumë më i vështirë për t’u matur. Përdorimi i energjive të rinovueshme sjell më pak amortizim në mjedis, duke e bërë kështu rritjen ekonomike më solide, dhe duke promovuar kështu zhvillimin e qëndrueshëm. Në kuadër të teorive rreth ndikimit që ka energjia në prodhimin e një vendi, tashmë teknologjitë e reja të prodhimit janë më eficiente dhe përdorin në një masë më të madhe energji elektrike. Kështu roli i energjisë elektrike në prodhimin e të mirave po rritet me hapa të shpejtë. Duke konsideruar këtë kanal, edhe roli i energjisë elektrike në stabilitetin ekonomik

²⁸ Hauang, 2013, p. 121.

po rritet së tepërmi. Nga një anë është përdorimi i tij si input për prodhimin e mallrave dhe ofrimin e shërbimeve, ndërsa nga ana tjetër si mall i domosdoshëm dhe tepër joelastik për konsumatorët. Vëmendja ndaj energjisë elektrike, me të drejtë, është në rritje.²⁹

Studimet mbi lidhjen midis konsumit të energjisë elektrike dhe rritjes ekonomike janë të shumta. Studimet më të shumta rreth kësaj lidhje janë kryer për vendet aziatike. Yoo²² zhvilloi një studim për të shqyrtuar marrëdhëniet shkakësore midis konsumit të energjisë elektrike dhe rritjes ekonomike për katër vendet e ASEAN-it, përkatësisht Indonezia, Malajzia, Singapori dhe Tailanda. Rezultatet empirike treguan se lidhja mes konsumit të energjisë elektrike dhe rritjes ekonomike ishte e dyanshme në Malajzi dhe Singapor. Nga ana tjetër, në Indonezi dhe Tailandë kjo lidhje u paraqit e njëanshme, nga ku rritja ekonomike ndikonte në konsumin e energjisë elektrike. Ndërkohë që studime të rëndësishme janë kryer edhe për vendet në tranzicion. Acaravci dhe Ozturk shqyrtuan marrëdhënien midis konsumit të energjisë elektrike në vendet e Europës Lindore dhe disa vende të Ballkanit, përfshirë edhe Shqipërinë, për vitin 1990 – 2006. Analiza e kointegrimit u krye për të dhënat panel (të agreguara), kështu që nuk u paraqitën rezultate në bazë vendesh. Megjithatë, analiza e kointegrimit nuk paraqiti ndonjë lidhje të rëndësishme shkakësore midis konsumit të energjisë elektrike dhe rritjes ekonomike në këto vende. Studimi konkludon duke sugjeruar mungesa e lidhjes vjen për shkak të problemeve që këto vende kanë pasur nga njëra ana me stabilitetin ekonomik dhe nga ana tjetër me tregun e energjisë elektrike. Gjithashtu, të njëjtët autorë, në një punim më të detajuar për Shqipërinë, Bullgarinë, Hungarinë dhe Rumaninë, në këtë rast me të dhëna nga viti 1980 – 2006, arritën po në të njëjtin konkluzion, duke mohuar një lidhje shkakësore midis tyre për këto vende.²⁵ Nga ana tjetër, përveç lidhjes së konsumit të energjisë elektrike me rritjen, ekzistojnë edhe lidhje të tjera. Në këtë rast, studimet e shqyrtuara analizojnë anën e ofertës, pra ndikimin që ka energjia elektrike në prodhim. Teoritë e fundit të rritjes ekonomike, në mënyrë të veçantë ato të rritjes endogjene kanë theksuar rolin e madh të progresit teknologjik dhe të produktivitetit.³⁰

2.3. HULUMTIME RELEVANTE PËR NDËRTESAT INTELIGJENTE

Sipas të dhënave të censusit të vitit 2011, krahasuar me vendet e EU-27, Kosova rezulton me indeksin më të ulët të "banesa/1000 banorë"; ky indeks rezulton të jetë rreth 360 [banesa/1000banorë). Nisur nga fakti që vendet e tjera arrijnë deri në 500 [banesa/1000 banorë] mund të themi që Kosova është ende e "pangopur" me banesa. Ndërkohë për vitin 2000, indeksi i konsumit final të energjisë për vendet e EU-27 & Kosovë tregon se Kosova ka indeksin më të ulët të konsumit energjistik,

²⁹ Boyd, 2009, p. 73.

³⁰ Beltran, 2009, p. 215.

vetëm 0.12 [toe/banorë] ose 1'395 [kWh/banorë], ndjekur nga Malta, Qipro, Bullgaria, Portugalia dhe Spanja. Që prej vitit 1998, Kosova është kthyer në importuese neto e energjisë elektrike. Kosto mesatare vjetore e importit të energjisë elektrike për periudhën 2002-2013 ka qenë 96,07 MilionEuro. Sipas të dhënave statistikore të marra nga raportet e ERE, rreth 70% e energjisë totale dhe rreth 64% e Energjisë elektrike në sektorin rezidencial shkon për i) Ngrohje, ii) Freskim dhe iii) Ujë tëngrohtë sanitar, ndaj çdo përpjekje për të ulur këtë konsum është me mjaft përfitim.³¹

Që prej vitit 1950, projektimi i sistemeve HVAC ka ardhur duke u përmirësuar dhe nivelet ekomfortit janë rritur në mënyrë të vazhdueshme. Pas viteve 70' shohim një përmirësim të dukshëm në rezistencën termike të ndërtesave rezidenciale pas futjes së termoizolimit dhe rritjes së hermeticitetit të tyre. Me rritjen e termoizolimit dhe hermeticitetit, u rrit ndjeshëm niveli i konfortit dhe konsumi i energjisë gjithmonë e më shumë reduktohet. Baza ligjore shqiptare është e plotësuar nga pikëpamja e ligjeve dhe adaptimit të Direktivave Evropiane, por nuk mund të thuhet e njëjta gjë për sa i përket rregulloreve apo ligjeve sekondare. Aktualisht e vetmja rregullore e miratuar në këtë fushë mbetet: VKM, Nr.38, datë 16.01.2003; "Për miratimin e normave, rregullave dhe kushteve të projektimit dhe të ndërtimit, të prodhimit dhe ruajtjes së nxehtësisë në ndërtesa. Objektivi i Direktivës 2010/31/EU për PEN është të promovojë përmirësimin e performancës energjike të ndërtesave nëpërmjet masave efektive nga pikëpamja e kostos, pa çënuar komfortin ose cilësinë e ajrit të brendshëm, dhe përputhjen e standardeve në ato vende anëtare të cilat kanë kërkesa ambicioze. Sipas kësaj direktive, vendet anëtare duhet të zhvillojnë metodologjinë kombëtare llogaritëse (MKLL) të PEN, bazuar jo vetëm përgjatë sezonit të ngrohjes por për gjithë vitin. Gjithashtu vendet anëtare duhet të vendosin për vlerat limit të PEN dhe telementeve të ndërtesës. Keto të fundit akoma nuk janë zhvilluar ende në Kosovë.³²

³¹ Commison, 2013, p. 74.

³² Ibid.

3. EFIÇIENCA E ENERGJISË ELEKTRIKE

3.1. SFIDAT DHE RËNDËSIA E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË

Efiçienca e Energjisë është një fushë e gjerë dhe një objektiv jo i lehtë për t'u arritur, që nënkupton uljen e konsumit të energjisë në një territor të caktuar. Politika të shumta publike hartohen me qëllim të rritjes së nivelit të kursimit të energjisë. Investimet në aspektin teknik, masat stimuluese, informimi dhe vetëdijesimi në këtë fushë janë pikat kryesore në rritjen e efiçencës.³³

Sot në mbarë botën edhe tek ne përmirësimi i Efiçencës së Energjisë në ndërtesa është bërë një sfidë e sidomos në vendet ku ka performacë të ultë energjetike. Për këtë arsye janë bërë shumë matje nga ekspertët e kësaj lëmie të cilët çdo ditë e më shumë po apelojnë në rritjen e vetëdijes së njerëzimit rreth rëndësisë së Efiçencës së Energjisë. Ata duhet të jenë të informuar në lidhje me rëndësinë e të kursyerit të energjisë dhe masat e vetëdijesimit duhet të jenë në shërbim të qytetarëve.³⁴

Për këtë çështje po ashtu edhe Parlamenti dhe Këshilli Evropian ka aprovuar Direktivën për Efiçencë të Energjisë. Kjo direktivë parasheh që deri në vitin 2020 vendet e Bashkimit Evropian duke përfshirë edhe vendin tonë janë të obliguara t'i përmbushin cakun 20-20-20 që do të thotë 20% e energjisë të përfitohet nga energjia e ripërtrishme, 20% nga rritja e efiçencës dhe 20% duke zvogëluar emetimin e dioksidit të karbonit (CO₂). Rolin kryesor për përmirësimin e Efiçencës së Energjisë në ndërtesa e ka termoizolimi për arsye të jetëgjatësisë. Po ashtu këtu duhet pasur parasysh edhe trendin e ngritjes së çmimeve për energji elektrike dhe lëndë djegëse. Izolimi i ndërtesave përfshinë: izolimin e mureve, ndërrimin e xhamave të zakonshme me ato termike (double-glazing), ndërrimin e dymave dhe izolimin e kulmit. Izolimi i mirëfilltë, natyrisht pa pasur ndikim në kualitetin e ajrit brenda objektit, mund të reduktoj deri në 30% konsumin e energjisë elektrike. Mirëpo, kjo shifër vlen për ato ndërtesa të cilat siburim të ngrohjes e kanë rrymën elektrike e jo drurin, gazin apo burimet tjera të ngrohjes. Izolimi i ndërtesave në Kosovë është esencial duke pasur parasysh se më shumë se 30% e konsumit të energjisë elektrike në Kosovë shfrytëzohet për ngrohje.³⁵

3.2. BARRIERAT E NDËRTIMIT SMART PËR EFIÇIENCEN E ENERGJIS ELEKTRIKE

Kostot e blerjes paraprake janë pengesa kryesore për investime në ndërtesa, të mençura dhe teknologjite e ndërtimit nuk bëjnë përjashtim. Është shumë e

³³ Bajgora, 2014, p. 141.

³⁴ Fabien, Roques, 2006, p. 61.

³⁵ Ibid.

zakonshme që sistemet e ndërtimit të pësojnë përmirësimet vetëm në pikën e dështimit; kostot e blerjes paraprake të disa ndërtesave inteligjente teknologjitë dekurajojnë azhurnimet më në kohë. Kostot e investimeve janë veçanërisht sfiduese për pronarët e ndërtesave të vogla dhe të mesme, të cilët zakonisht kanë më pak kapital për të punuar dhe për të bërë përmirësime. Përveç kësaj, industritë financiare dhe të sigurimeve nuk kanë ende pranim të vlerësimit e veçorive të ndërtimit inteligjent për vlerësim dhe nënshkrim të saktë. Ndërtesat inteligjente përballen me një numër pengesash të tjera. Operatorët e ndërtesave ballafaqohen me kurba e pjerrët. Blerësit mund të hezitojnë të investojnë për shkak të shqetësimeve mbi kohën e parakohshme dhe vjetërsimi i teknologjisë së re. Industria ende nuk ka standardizuar komunikimet në protokoll për ndërlidhjen e pajisjeve inteligjente.³⁶

Ndërtesat inteligjente mund të centralizojnë kontrollin dhe monitorimin e sigurisë, aksesit dhe sistemeve të sigurisë, duke ngritur shqetësimin se sisteme të tilla do të jenë shënjestra e kërcënimeve të sigurisë kibernetike. Së fundmi, mungesa e vetëdijes dhe boshllëqet e konsumatorëve në grupet e aftësive të fuqisë punëtore gjithashtu ndikojnë në përhapjen e teknologjive inteligjente. Nëse këto teknologji janë për t'u përhapur në treg, industria e ndërtimit duhet të kuptojë propozimi e vlerës së ndërtesave dhe fillojnë të zhvendosin kulturën e operatorit të ndërtesës.³⁷

3.3. PROGRAMET E NDËRTESES INTELIGJENTE NË KURSIMITIN E ENERGJIS ELEKTRIKE

Teknologjitë inteligjente që shpesh stimulohen përmes efikasitetit të energjisë të recetave të shërbimeve programet përfshijnë kontrole të përparuara të përdorimit dhe vendeve të lira të punës që punojnë me ndriçimin dhe Sistemet HVAC, kontrollet e ndriçimit të ditës, shiritat inteligjentë të rrymës dhe prizat inteligjente dhe BMS. Për dritaret, stimujt ndonjëherë ekzistojnë teknologjitë pasive të hijezimit siç është smart filma dhe ekrane. Disa programe të pagimit për performancën dhe përgjigjen e kërkesës kanë filluar duke përfshirë sensorë, metra, invertorë dhe softuerë analitikë në portofolet e tyre për të treguar se si është një ndërtesë, kryerja në kohë reale dhe identifikimi i mundësive të kursimit të energjisë.³⁸

Këto duke bërë të mundur që teknologjitë mund të verifikojnë kilovat-orë (kWh) të kursyera nga masat e efijencës së energjisë së nevojshme për programet e performancës; ato gjithashtu lejojnë klientët të marrin pjesë në kërkesë. Disa ndërmarrje kanë filluar së fundmi ose planifikojnë të hapin programe inteligjente me stimuj që paguajnë për kilovat gjenerimi nga DER. Dhe disa programe kanë filluar të paguajnë jo vetëm për pajisje por edhe për shërbime të palëve të treta në vazhdim për të monitoruar dhe sugjeruar përmirësime operationale të ndërtesave. Një

³⁶ Jobst, 2001, p. 195.

³⁷ Fiance, 2013, p. 142.

³⁸ Ibid.

ndërtesë e zgjuar mund të përmirësojë vlerësimin, matjen dhe verifikimin tradicional saktësinë duke mbledhur të dhëna të performancës energjetike të sistemeve të ndërtimit në kohë reale më shumë intervale të shpeshta. Kjo mundëson sasinë e vazhdueshme të kursimit të energjisë dhe jep tek menaxherët e programit reagime në kohë reale për performancën e projektit.³⁹

3.4. VARFËRIA ENERGJETIKE

Me varfëri energjetike nënkuptojmë situatën në të cilën një familje nuk mund t'i përballojë mbulimin e shpenzimeve të energjisë elektrike. Faktorët që përcaktojnë se a jemi apo jo në varfëri energjetike janë: eficientia e energjisë në ndërtesa, çmimi i energjisë si dhe të ardhurat personale apo të hyrat financiare në familje. Koncepti i varfërisë energjetike në vendin tonë është një koncept shumë pak i njohur dhe i trajtuar edhe pse është i lidhur ngushtë me jetën e qytetarëve.

Spektori i ndërtesave rrezikohet nga varfëria energjetike si rezultat i 5 faktorëve që janë:

- Rritja e çmimit të energjisë elektrike është më e lartë në krahasim me rritjen e të ardhurave personale,
- Pamundësia për të siguruar energji me çmim më të ulët,
- Nevojat familjeve në rritje çdo ditë e më tepër për energji,
- Mungesa e eficientës në përdorimin e energjisë si dhe
- Ndërhyrjet e politikave.⁴⁰

Në mënyrë që vendi ynë t'i shmanget këtij fenomeni duhet që të ndërmarrin masa të ndihmojnë popullatën, qoftë në subvencione, po ashtu edhe në marrëveshje me banka në mënyrë që të kenë norma interesi më të ulëta duke ju krijuar kushte të volitshme për investime në marrjen e masave eficiente.⁴¹

3.5. ROLI I ENERGJISË NË PËRDITSHMËRI DHE HUMBJA E SAJ


Energjia elektrike luan rol të rëndësishëm në jetën tonë. Ajo në konsum ditor për nevoja elementare shpenzohet si vijon:

³⁹ Fabien, Roques, 2006, p. 67.

⁴⁰ Krasniqi, 2014, p. 90.

⁴¹ Ibid.

Grafikoni 1: Konsumi ditor i energjisë elektrike në sektorin familjar




Burimi: Instituti për energji elektrike në Republikën e Kosovës, 2015. p. 65.

Nga figura vërejmë se pjesa më e madhe e energjisë, sidomos gjatë stinës së dimrit, shpenzohet për ngrohjen e hapësirave. Me qëllim të uljes së shpenzimeve në këtë aspekt nevojitet ndërtim termoizolues apo termoizolim i ndërtesës ekzistuese. Por cilat janë përfitimet nga ndërtimi eficient? Përgjigjja është e thjeshtë: Me ndërtim eficient do të thotë kursim i energjisë elektrike, pra kursim i parave për faturë të energjisë elektrike, komfort termik, cilësi jetese, jetëgjatësi të ndërtimit, kontribut në mbrojtjen e mjedisit ndaj ndotësve që shkaktohen nga djegia e lëndës djegëse si dhe rritje e vlerës së ndërtesës. Për ngrohje të përshtatshme rol me rëndësi luan edhe zona ku është ndërtuar objekti si dhe kërkesa e banueseve të saj. Në një ndërtesë banimi nxehtësia humbet për rreth 35% nëpërmjet mureve të jashtme, 25% përmes dyerve dhe dritareve, 15% nëpërmjet dyshemesë si dhe 25% përmes kulmit.⁴²

⁴² Instituti për energji elektrike në Republikën e Kosovës, 2015. P.65

Figure 1: Humbjet e nxehtësisë



Burimi: Instituti i Energjis - Gjendja e sektorit të energjisë dhe veprimtaria e Entit Rregullator të Energjisë gjatë vitit 2013, p. 78.

Duke pasur parasysh se humbjet më të mëdha të nxehtësisë janë përmes mureve të jashtme apo rrethuese të ndërtesës atëherë për arsye të ruajtjes së nxehtësisë duhet që këto mure të termoizolohen. Termoizolimi bëhet me materiale të cilat kanë veti të mira termoizoluese dhe koeficient të përcjellshmërisë termike nga $U = 0.025 - 0.040 \text{ W/m}^2\text{K}$. Ekzistojnë lloje të ndryshme të materialeve termoizoluese siç janë: polisteroli, leshi mineral, poliuretani, celuloza etj. Materiali më i përshtatshëm dhe më efikas është polisteroli. Izolimi me polisterol bëhet në pjesët e jashtme apo të brendshme të mureve të ndërtesës. Termoizolimi i jashtëm bëhet zakonisht në ndërtesat e reja apo ato të vjetra private kurse termoizolimi i brendshëm bëhet në ato ndërtesa në të cilat kërkohet ruajtja e trashëgimisë.⁴³

3.6. KOMFORI I BRENDSHËM TERMİK

I gjithë investimi bëhet për një arsye e ajo është që të arrihet një komfor i përshtatshëm termik për njerëzit dhe shëndetin e tyre në mënyrë që të ndihen sa më mirë. Komfort termik do të thotë të ketë harmoni në mes të njeriut dhe ambientit që e rrethon. Komforti termik varet nga: temperatura, lagështia relative, shpejtësia e rrymimit të ajrit, ndriçimi etj. Po ashtu faktorë tjerë të cilët ndikojnë në komfortin termik të trupit të njeriut janë edhe aktiviteti fizik, veshmbathja, pastërtia e ajrit, mosha, gjinia

⁴³ Jobst, 2001, p. 201.

etj. Po qe se një ambient është i ftohtë apo shumë i ngrohtë atëherë kemi të bëjmë me diskomfortin termik. Diskomfortin termik në të shumtën e rasteve e shkakton rryma e ajrit, ndryshimi i madh i temperaturës së trupit të njeriut siç njihet si ndryshim vertikal i temperaturës ndërmjet kokës dhe shputave të këmbës nga dyshemeja shumë e ftohtë apo shumë e ngrohtë ose nga temperatura rrezatuese asimetrike. Komforti termik ndryshon dhe, deri në njëfarë shkalle, varet nga klima e vendit ku jeton njeriu, kështu që kushtet e komfortit të vendosura për një popull nuk vlejnë për një popull tjetër. Definimi i këtyre kushteve dhe përgjithësimi i tyre paraqet problem shumë kompleks. Për ta bërë një analizë më të plotë lidhur me këtë problematikë është ndërtuar një model, i cili përfshin nxehtësinë e përgjithshme të transmetuar nga njeriu në ambientin rrethues me përcjellshmëri, konveksion, rrezatim dhe me respiracion (avullim) të cilat janë ërcaktuar nga barazimet përkatëse sipas ligjeve të transmetimit të nxehtësisë.⁴⁴

3.7. NDIKIMI I SHTRESAVE TË MUREVE, DYERVE DHE DRITAREVE NË KOMFORIN TERMIK

Ndikimi i shtresave të murit përveç parametrave të përcjellshmërisë dhe trashësisë varet edhe nga renditja në të cilin janë vendosur materialet e ndryshme kundrejt drejtimit të fluksit termik. Kështu kur bëhet izolimi i mureve ai duhet të bëhet nga brenda, jashtë apo në mes në të gjithë objektin. Po qe se këto do të jenë të renditura ndryshe në të njëjtën ndërtesë do të na japin temperaturë jo të njëjtë, çka shkakton diskomfort termik. Koncepte bazë të sistemit izolues janë përcjellshmëria termike, koeficienti i transmetimit të nxehtësisë dhe rezistenca termike.⁴⁵

- Përcjellshmëria termike λ (W/m²K) – është perimetri që identifikon sjelljen termike të materialeve në transmetimin e nxehtësisë,
- Koeficienti i transmetimit të nxehtësisë U (W/m²K) – merret nga raporti i koeficientit të përcjellshmërisë termike λ me trashësinë ρ .
- Rezistenca termike R (m²K/W) – shprehet me inversin e koeficientit të transmetimit të nxehtësisë $1/U$. Siç e kemi cekur më lartë rreth 25% e nxehtësisë të një objekti banimi humbet përmes dyerve dhe dritareve. Dritarja është pjesë e rëndësishme e një ndërtese për arsye se mundëson ndriçimin e hapësirave të brendshme, absorbon energjinë diellore si dhe shërben për ajrosje.⁴⁶

Edhe për dritare është e rëndësishme koeficienti transmetimit të nxehtësisë i cili nuk duhet të jetë më i madh se $U = 1.8 - 2.8$ W/m²K për dritare të materialit PVC me xham të dyfishtë. Po ashtu edhe për dyer ky koeficient nuk guxon të kalojë vlerën $U = 2.8 - 3.5$ W/m²K. Që një ndërtesë private apo publike të jetë efiçente gjithashtu duhet që dyshemeja dhe kulmi të jenë të izoluar me materiale termoizoluese. Me fjalë tjera nëse një shtëpi, banesë, ndërtesë në përgjithësi kur të merret vendimi për ta blerë

⁴⁴ Jacobsson, 2003, p. 203.

⁴⁵ Nelson, 2013, p. 141.

⁴⁶ Krasniqi, 2014, p. 95.

përveç çmimit është e rëndësishme të pyesim për cilësinë e ndërtimit dhe Eficiencën Energjetike. Një shtëpi/banesë e termoizoluar do të shpenzojë më pak energji për ngrohje gjatë stinës së dimrit dhe për ftohje gjatë verës.⁴⁷

3.8. KONTROLLIMI I ZONAVE TË SHUMËFISHTA

Optimizimi i përdorimit të ajrit të kondicionuar është një nga aplikimet më efektive të smart pajisjet e ndërtimit, veçanërisht në sistemet me shumë zona. Për shembull, një ndryshore me shumë zona sistemi i vëllimit të ajrit (VAV) me gjashtë kuti VAV mund të përdorë kontrole inteligjente në mënyrë më efektive në secilën nga gjashtë zonat. Me sensorë të instaluar në secilën zonë zyre, secila kuti VAV mund të programohen të kthehen ose të mbyllen plotësisht kur është hapësira përkatëse bosh. Nëse shumica e punonjësve janë jashtë zyrës, kontrollet inteligjent mund të zvogëlohen ose të mbyllen jashtë kondicionimit në ndonjë ose të gjashtë zonat për të kursyer energji. Një shembull tjetër më pak efikase është një dysheme e tërë me një sistem të vëllimit konstant të ajrit (CAV) i shërbyer nga një njësi e trajtimit të ajrit. Në këtë rast, opsionet e kontrollit janë të kufizuara në çiklizmin mbrapa ose fikjen e rrjedhjes së ajrit në gjithë dyshemenë, dhe fleksibiliteti i kontrollit të zonës mungon.⁴⁸

Dhomat e hotelit, të cilat mund të konsiderohen zona individuale, ofrojnë një aplikim unik për kursimi i energjisë kontrollon zonën. Dhomat e hotelit Njësitë HVAC zakonisht qëndrojnë të caktuara temperaturën e zgjedhur për herë të fundit nga mysafiri ose pastrimi, duke kondicionuar kështu mysafirin e pa zënë dhoma. Kjo mund të harxhojë qindra mijëra kWh energji elektrike dhe dhjetëra mijëra energji elektrike dollarë në energji kushton çdo vit. Lidhja e kontroleve të vendeve të lira të dhomave të miqve dhe HVAC kontrollet e sistemit lejojnë që hotelet të vendosin përsëri temperaturën kur dhoma është e lirë. Enatyrisht, operatorët e ndërtesave duhet të balancojnë këto masa të kursimit të energjisë me përdoruesit rehati për të siguruar që mysafirët të mos përjetojnë shqetësime kur kthehen në dhomat e tyre.⁴⁹

Navigant vlerësoi se vetëm 30% e industrisë globale të mikpritjes përdor aktualisht sisteme të menaxhimit të energjisë me bazë dhome për të zvogëluar konsumin e HVAC (Pacelle dhe Bloom)

2014) Kjo shifër ka të ngjarë të jetë edhe më e ulët në Shtetet e Bashkuara, sepse relativisht pak hotele amerikane përmbajnë kontrole inteligjente HVAC krahasuar me hotelet në shumë pjesë të Azisë dhe Evropës.⁵⁰

⁴⁷ Mananteu, 2003. p. 57.

⁴⁸ Jon, 2012, p. 97.

⁴⁹ Shrestha, 2007, p. 50.

⁵⁰ Gandibleux, 2005, p. 31.

3.10. HIJËZIMI I DRITARES

Rreth një e treta e përdorimit të energjisë HVAC të ndërtesave komerciale është për shkak të fitimeve dhe humbjeve të nxehtësisë nga dritaret. Komisioni i Energjisë në Kaliforni vlerëson se afërsisht 40% e kërkesës për ftohje për një ndërtesë tipike në Kaliforni është për shkak të fitimi i nxehtësisë diellore përmes dritareve. Lidhjet e dritareve, aq të thjeshta sa hijet manuale, kanë provuar të jenë një masë me kosto të ulët për zvogëlimin e përfitimit të nxehtësisë diellore dhe shkëlqimit të ndritshëm. Sidoqoftë studimet në terren e kanë treguar atë manualisht hijet e operuara, pasi ulen për të zvogëluar shkëlqimin e ndritshëm, shpesh mbeten të ulura pavarësisht nga ndryshimet në nivelet e dritës së jashtme, duke sakrifikuar mundësitë e dritës.⁵¹

Hijet e dritareve të motorizuara, kontrollohen nga ndërprerësit manualë ose kohëmatës analoge, xhami dhe filmat e lyer janë të vjetër me dekada teknologjitë e krijuara për të thithur të gjithë spektrin e dritës së diellit, duke zvogëluar dielloren nxehtësia që hyn në ndërtesa dhe zvogëlon dritën e dukshme për të zvogëluar shkëlqimin e ndritshëm. Dritare më e vjetër teknologjitë e hijëzimit nuk përfshinin tiparet e ndriçimit të ditës.⁵²

Sistemet e hijeve të kontrolluara automatikisht shkojnë një hap më tej, duke iu përgjigjur ndryshimeve në kushtet e temperaturës së jashtme dhe të brendshme gjatë një dite pa u mbështetur kontributi njerëzor. Hije diellore-adaptive punojnë në të njëjtën mënyrë në përgjigje të pozicionit të diellit. Këto nuanca inteligjente mbështeten në sensorë që masin ambientin e brendshëm dhe të jashtëm temperaturat ose pozicioni dhe rrezatimi i diellit, duke rregulluar automatikisht lartësinë e tyre në menaxhoni sasinë e dritës dhe nxehtësisë që hyjnë në ndërtesë. Këto pajisje mund të integrohen me ndriçim dhe sisteme të menaxhimit të ndërtesave për kontroll të centralizuar. Kur shtohet në a projekti i rikonstruksionit të ndriçimit për të maksimizuar ndriçimin e ditës, hije të zgjuara ofrojnë një shtesë prej 10% kursimet e energjisë në ndriçimin e përdorimit të energjisë.⁵³

Xhamat e përparuar të dritareve mund të kursejnë edhe më shumë energji dhe xham pasiv teknologjitë (të tilla si xhami i ulët me E) janë në dispozicion. Xhami tradicionale ka bronz ose ngjyrosje gri. Përparimet në ngjyrosjen tani arrijnë një spektër më të gjerë ngjyrash, duke lejuar dritën e dukshme të kalojnë në brendësi të ndërtesës duke ulur përfitimin e nxehtësisë diellore. Kohët e fundit zhvillimet në filmat me dritare, të tilla si reflektimi i dyfishtë, kontrolli diellor dhe drita e ditës ridrejtimi i filmave, mund të zbatohet në dritaret ekzistuese të lyer për të arritur hijëzimin përfitimi i qelqit të lyer. Këto përparime të thjeshta, me çmim të moderuar në teknologji zakonisht shoqërojnë modelet e ndriçimit të ditës në ndërtimet komerciale të ndërtesave, dhe shtoni ato përfitimi i zvogëlimit

⁵¹ Hauang, 2013, p. 29.

⁵² Shrestha, 2007, p. 70.

⁵³ Mananteu, 2003, p. 59.

të përfitimit të nxehtësisë diellore dhe shkëlqimit të ndritshëm. Një studim i rikonstruksionit të filmit në dritare në ndërtesat në California gjeti një kthim mesatar të investimit (ROI) prej 39% për filmat e aplikuar në dritare me një dritare dhe 25% për aplikimet me dritare me dy dritare. Teknologjitë e qelqit pasiv janë gjithashtu trende në tregun e ndërtesave inteligjente. Sidoqoftë ata mungojnë kontrollet e rrejtë dhe aftësia për tu integruar me sistemet e tjera të ndërtimit. Dy lloje të sistemeve pasive të dritareve që vlen të përmenden janë fotokromike dhe termokromike, të cilat rregulloni në mënyrë autonome ngjyrën e tyre, përkatësisht, sipas dritës dhe temperaturës. Xhami fotokromik transmeton nivele të ndryshme të dritës në ndërtesë sipas ndryshimeve në dritën e diellit. Xhami termokromik ndryshon sipas luhatjeve të temperaturës në ambient të jashtëm, lejimin ose parandalimin e hyrjes së nxehtësisë diellore në ndërtesë. Një i zgjuar termokromik dritarja, RavenWindow 2.0, doli në treg në 2012; pretendon 30% kursim të energjisë dhe një Roi prej tre deri në pesë vjet (RavenWindow 2016). Xhami inteligjent aktiv, ose elektrokromik, kontrollohet elektrikisht. Njihet me emra të ndryshëm përfshirë xhamin aktiv, të kalueshëm dhe të ngarkuar elektronik, ndihmon në kontrollin e ndriçimit të ditës dhe nxehtësisë diellore transferimi.⁵⁴

Ngjyrosja e dritares drejtohet nga një ngarkesë e tensionit të ulët në përgjigje të intensitetit diellor dhe temperatura e ambientit. Ndryshimet në tension ndryshojnë reflektimin dhe thithjen e rrezeve të diellit vetitë e xhamit. Filmat vet-ngjitës të ngarkuar me E janë gjithashtu në dispozicion në treg. Xhami dhe filmat e ngarkuar ndryshojnë nga i errët në të pastër, ose zbehen përgjatë një shkalle gri në mes, në varësi të ngarkesës elektrike të marrë. Këto gota dhe filma po bëhen gjithnjë e më popullore në ndërtimet e hapësirave të qiramarrësve për muret e ndarjes së brendshme sepse ato lejojnë drita e ditës të depërtojë në hapësirë kur është e qartë dhe të sigurojë privatësi kur është e paqartë. Përfitimet joenergjetike të ndërtesave inteligjente dhe pengesat për miratimin e tyre.⁵⁵

3.11. Masat për mbrojtje termike gjatë projektimit dhe ndërtimit të ndërtesës

Gjatë projektimit të ndërtesës duhet të merret parasysh mbrojtja termike e ndërtesës me qëllim që të zvogëlohen humbjet termike nga brenda – jashtë gjatë periudhës së dimrit ndërsa gjatë verës të pengohet rrezatimi i tepërt i diellit. Këto masa duhet të merren parasysh nga projektuesit. Masat për mbrojtje termike përbëhen nga: arkitektura, lokacioni, orientimi ndërtesës, planimetria brenda ndërtesës, strukturat e ndërtimit, kushtet klimatike të vendit, lënda djegëse që do të përdoret për ngrohje etj. Me orientimin e ndërtesës kah jugu transmetimi i nxehtësisë ka vlerat më të përshtatshme për ngrohjen e ambienteve në dimër dhe ftohjen e tyre në verë. Pra rekomandohet që ambientet ku njerëzit më tepër qëndrojnë të jenë të orientuara nga

⁵⁴ Krasniqi, Sahiti, 1998, p. 30.

⁵⁵ Shimon, 2004, p. 139.

jugu. Temperaturat e brendshme projektuese (disa prej tyre) sipas qëllimit të përdorimit të ambienteve në ndërtesë janë.⁵⁶

Table 1: Vlerat e rekomanduara të temperaturës së brendshme në ndërtesa

Lloji i hapësirës	tb (°C)
Hapsirat e ndejës	+20
Ambiente shkollore	+20
Kuzhine	+20
Banjo	+24
Korridoret	+15
Sallë koncertesh, teatri, kinemaje	+20
Zyra	+20

Burimi: Instituti i Energjis - Gjendja e sektorit të energjisë dhe veprimtaria e Entit Rregullator të Energjisë gjatë vitit 2014, p. 81.

3.12. POTENCIALI I PËRMIRËSIMIT TË EFIÇIENCËS SË ENERGIJË NË SEKTORË TË NDRYSHËM – SEKTORI I NDËRTESAVE

Në Republikën e Kosovës deri në dhjetëvjeçarin e fundit, nuk i është dhënë rëndësi e duhur Efiçencës së Energjisë gjatë ndërtimit të ndërtesave qoftë publike po ashtu edhe atyre private. Efiçienca e ulët e energjisë në këto ndërtesa ka rritur kërkesën për konsum të energjisë elektrike dhe përdorimin e lëndëve fosile. Për këtë arsye sot po bëhen përpjekje në bashkëpunim me faktorët ndërkombëtarë që të zbatohet në strategji gjithëpërfshirëse në përmirësimin e politikave për energjinë e ripërtërishme dhe Efiçencën e Energjisë. Sipas një vlerësimi të tregut të bërë nga Banka Botërore në vendin tonë është vërtetuar e sektori i ndërtesave përbën 47.5% të konsumit të energjisë. Rritja e numrit të popullsisë ka bërë që të rriten kërkesat për energji në Kosovë. ⁵⁷Duke marrë parasysh faktin se Republika e Kosovës nuk e ka të zhvilluar sistemin e gazit natyror si dhe nuk është pjesë e rrjetit Evropian të gazit, pothuajse të gjitha shërbimet si ngrohja e hapësirave, kondicionimi, gatimi, uji i ngrohtë sanitar,

⁵⁶ Ralph, Sisma, 2003, p. 134.

⁵⁷ Shimon, 2004, p. 141.

ndriçimi dhe pajisjet e ndryshme elektro-shtëpiake mbulohen nga energjia elektrike, drutë dhe nënproduktet e naftës. Aktualisht, sektori i ngrohjes së ndërtesave në Republikën e Kosovës përbëhet nga 4 sisteme.⁵⁸

- 1 Ngrohja qendrore “Termokos” – Prishtinë,
- 2 Ngrohja qendrore – Gjakovë,
- 3 Ngrohja qendrore “Termomit” – Mitrovicë, dhe
- 4 Ngrohja qendrore – Zveqan.

Shtrirja e këtyre ngrohtoreve në vendin tonë është shumë e kufizuar dhe mbulon vetëm 3 – 5% të kërkesës së përgjithshme për ngrohjen e hapësirave. Rritja e sistemeve të ngrohjes qendrore do të ishte mjaft sfiduese dhe e rëndësishme për zhvillimet e sektorit të energjisë në Republikën e Kosovës. Me investimet për Eficiencë të Energjisë do të realizohen qëllimet e politikës energjetike të vendit siç janë: mbështetja e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik, rritja e sigurisë së furnizimit me energji dhe mbrojtja e mjedisit. Këto investime paraqesin potenciale të konsiderueshme për zbatimin e Eficiencës së Energjisë në Republikën e Kosovës, së bashku me nevojën për kursim dhe përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve. Sa i përket anës ligjore deri më tani janë marrë hapa të rëndësishëm politik, legal dhe institucional për promovimin e Eficiencës së Energjisë, janë investuar miliona Euro, posaçërisht nga Bashkimi Europian, në sektorin e ndërtesave publike për përmirësimin e gjendjes së tyre ekzistuese, por ende⁵⁹ mbetet të punohet në këtë sektor.⁶⁰

3.13. BAZA LIGJORE SHQIPTARE

Energjia është një nga çështjet aktuale më të diskutuara jo vetëm në Kosovë, por në të gjithë botën. Më poshtë po listojmë disa prej ligjeve, rregulloreve, VKM-ve, etj, Evropiane dhe Shqiptare, më të rëndësishme në fushën e energjisë.⁶¹

- VKM Nr.584, datë 2.11.2000 “Për Kursimin e Energjisë dhe Ruajtjen e Ngrohtësisë në Ndërtime”;
- Ligji Nr. 8937, datë 12.9.2002 “Për ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa”;
- Ligji Nr. 8987/2002, “Për krijimin e kushteve lehtësuese për ndërtimin e burimeve të reja të gjenerimit të energjisë elektrike”
- Ligji Nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”;
- VKM Nr. 424, datë 26.6.2003 “Për aprovimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë”;
- *VKM, Nr.38, datë 16.01.2003; “Për miratimin e normave, rregullave dhe kushteve e projektimit dhe të ndërtimit, të prodhimit dhe ruajtjes së nxehtësisë në ndërtesa;*
- Ligji Nr. 9379, datë 28.04.2005, “Për eficiencën e energjisë”;

⁵⁸ Hauang, 2013, p. 35.

⁵⁹ Ibid.

⁶⁰ Veatch, 2000, p. 49.

⁶¹ Lazarad, 2014, p. 91.

- Ligji Nr.9876, datë 14.02.2008 “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme për transport”;
- Ligji Nr.10113, datë 9.4.2009, “Për treguesit e konsumit të energjisë dhe të burimeve të tjera, nga pajisjet për përdorim shtëpiak, nëpërmjet etiketimit dhe informacionit standard të produkteve”;
- VKM Nr.619, datë 7.9.2011, “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për efikasitetin e energjisë, 2011-2018”;
- Ligji Nr. 138, datë 2.5.2013, “Për Burimet e Energjisë së Rinovueshme”;
- Ligji Nr. 26/2014 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 138/2013, "Për burimet e energjisë së rinovueshme”;
- Ligji Nr.124/2015 "Për Efikasitetin e Energjisë”;
- Ligji Nr.116/2016 "Për Performancën e Energjisë së Ndërtimeve", i cili shfuqizon Ligjin nr. 8937, datë 12.9.2002, “Për ruajtjen e nxehtësisë në banesa”;
- Ligj Nr. 7/2017 Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, i cili shfuqizon Ligjin Nr. 138, datë 2.5.2013, “Për Burimet e Energjisë së Rinovueshme”.⁶²

Zanafilla e legjislacionit shqiptar në lidhje me kursimin e energjisë daton në vitin 2000, kur qeveria e atëhershme miraton VKM nr.584 “Për kursimin e energjisë dhe ruajtjen e ngrohtësisë në banesa”. Sipas këtij vendimi, të gjitha objektet, që do të ndërtoheshin për banim, si dhe ndërtimet publike a private detyrohen të vendosin në ndërtesa instalimet e ngrohjes qendrore vendore ose individuale me burime energjetike lëndë djegëse organike, të ngurta, të lëngta dhe të gazta. Në asnjë rast sistemet e ngrohjes nuk duhet të parashikoheshin me përdorim të energjisë elektrike.⁶³

Për të krijuar bazën ligjore të nevojshme për vendosjen e rregullave dhe bërjen të detyrueshme të marrjes së masave për ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa, u aprovua Ligji Nr. 8937, datë 12.9.2002 “Për ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa”. Sipas këtij ligji, projektimi dhe ndërtimi i ndërtesave duhet të realizohet sipas parametrave teknik të nevojshëm për ruajtjen, kursimin dhe përdorimin me efikasitet të energjisë. Të gjitha ndërtesat që do të ndërtoheshin pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të respektonin koeficientin volumor normativ të humbjeve termike me transmetim (G_{vtn}), si dhe të parashikonin vendosjen e instalimit termik Ky ligj krijoi bazën ligjore të nevojshme për miratimin e normave dhe rregullave sipas VKM Nr.38, datë 16.01.2003; “Për miratimin e normave, rregullave dhe kushteve e projektimit dhe të ndërtimit, të prodhimit dhe ruajtjes së nxehtësisë në ndërtesa”. Në bazë të këtij vendimi u aprovuan koeficientët volumor normativ të humbjeve termike me transmetim (G_{vtn}) në funksion të faktorit të formës së ndërtesës (S/V) dhe gradë-ditëve të ngrohjes (GDN). Ky vendim përcakton gjithashtu kërkesat për termoizolim si dhe masat që duhet të merren për të siguruar izolimin termik të

⁶² Bashkimi Europian. (BE). Direktiva 2009/28/EC. Per promovimin dhe përdorimin e energjise se rinovueshme.

⁶³ Markowitz, 1951, p. 113.

ndërtesave. Gjithashtu shërben për llogaritjen e kërkesës për nxehtësi që nevojitet për ngrohjen dhe freskimin e ndërtesave, publike dhe private. Edhe pse është tentuar shpesh përditësimi i këtij vendimi, mbetet ende në fuqi versioni i vitit 2003 të ngrohjes qendrore.⁶⁴

Përgjatë këtyre viteve, zbatimi i ligjeve dhe vendimeve për ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa ka hasur një sërë problematikash. Edhe pse në projektet e hartuara dhe dorëzuara për leje ndërtimi objektet kanë qenë të pajisura me sisteme ngrohje qendrore, në realitet gjatë fazës së ndërtimit të tyre, kompanitë ndërtuese janë mjaftuar vetëm me instalimin e tubave të shpërndarjes edhe pse sipas paragrafit 5, të VKM Nr.584, datë 2.11.2000 "Për Kursimin e Energjisë dhe Ruajtjen e Ngrohtësisë në Ndërtime, kryerja e procedurave të kolaudimit të objekteve dhe marrja në dorëzim e tyre do të bëhej pas provave me ngarkesë të sistemit të ngrohjes.⁶⁵

Gensler, një firmë e arkitekturës dhe dizajnit, instaloi ndriçim dhe sensorë LED me efikasitet të lartë në të gjithë hapësirën e tyre, duke u siguruar udhëheqësve të dhëna të ndriçimit të ditës, shfrytëzimit, termike dhe energjisë. Përmes një sistemi të centralizuar të kontrollit, Gensler optimizoi nivelet e dritës bazuar në hapësirat individuale dhe mënyrën e përdorimit të tyre. Prodhimi i ndriçimit në hapësirat e tyre të hapura të punës u zvogëlua me 25%, duke kursyer energji dhe para. Për shkak të ndryshimeve, kompania gjithashtu pa një rritje prej 25% të kënaqësisë në vendin e punës.¹¹⁷

Me teknologjitë IoT dhe lidhjen cloud vijjnë shqetësimet në lidhje me sigurinë. Kur zgjedhni teknologjitë e ndërtimit inteligjent, është e rëndësishme të zgjidhni shitës që demonstrojnë një përkushtim ndaj sigurisë kibernetike. Teknologjitë e sigurta duhet të kenë masa mbrojtëse të tilla si mbrojtja e lidhjes në internet, mbrojtja e pajisjeve në ambiente, mbrojtja e kredencialeve të përdoruesit etj. Vizitoni Autoritetin e Kërkimit dhe Zhvillimit të Energjisë së Shtetit të New York-ut (NYSERDA) për një listë të shitësve të kualifikuar të teknologjisë inteligjente që plotësojnë standardet e sigurisë së lartë dhe mbrojtjen e të dhënave.¹¹⁸

Gati për të vendosur energji për të punuar për biznesin tuaj? Vizitoni sitin Tregtar dhe Industrial të NYSERDA për të mësuar se si organizata juaj mund të fillojë krijimin e një ndërtese më të zgjuar. NYSERDA, një korporatë me përfitim publik, ofron informacione dhe analiza objektive, programe inovative, ekspertizë teknike dhe mbështetje për të ndihmuar banorët e Nju Jorkut të rrisin efikasitetin e energjisë, të kursejnë para, të përdorin energji të rinovueshme dhe të zvogëlojnë varësinë të lëndët djegëse fosile. Profesionistët e NYSERDA punojnë për të mbrojtur mjedisin dhe për të krijuar punë me energji të pastër.¹¹⁹

3.20. INTELIGJENCA IOT DHE MENAXHIMIN E ENERJISË

Pronarët e ndërtesave moderne janë të dashuruar nga mundësia e të qenit në gjendje të zvogëlojnë faturat mujore të energjisë dhe përdorimin e burimeve duke monitoruar dhe kontrolluar mbi të ndërtimi në çdo kohë pa pasur nevojë të jesh i pranishëm fizikisht. IoT po e bën këtë koncept a realitetin dhe transformimin e menaxhimit të thjeshtë të energjisë së ndërtesës në energji inteligjente të ndërtesës menaxhimi. Me IoT, çdo objekt fizik i pranishëm brenda ndërtesës do të jetë të rrjetëzuara përmes internetit përmes sensorëve dhe programeve kompjuterike që u mundësojnë këtyre objekteve komunikoni me njëri-tjetrin dhe me përdoruesin përmes internetit. Disa nga aplikacionet e menaxhimit të energjisë së një ndërtese inteligjente përfshijnë efikasitetin e energjisë kontrolli i aksesit, kontrolli i ndriçimit, zbulimi i zjarrit / rrjedhjeve, ngrohja, ventilimi dhe ajri monitorimi i kondicionimit (HVAC) dhe kontrolli i temperaturës, dhe ndërtimi i përmirësuar siguria. Disa nga zhvilluesit kryesorë të sistemit të menaxhimit të energjisë në ndërtesa (BEMS)

¹¹⁷ Ralph, Sisma, 2003, p. 210.

¹¹⁸ Lazarat, 2014, p. 35.

¹¹⁹ Shrestha, 2007, p. 150.

përfshijnë Schneider Electric, Honeywell, Siemens dhe Johnson Controls. BEMS të zhvilluara nga këto kompani janë sisteme llogaritëse me aftësi përfshirë monitorimi dhe kontrolli i automatizuar dhe i konsumit të energjisë në kohë reale dhe i avancuar ndërtimi i analizave duke përdorur të dhëna historike dhe në kohë reale.¹²⁰

Ndërtesat inteligjente janë një treg me rritje të shpejtë

Ndërtesat tregtare konsumojnë shumë energji. Në fakt, sipas Zyrës së Teknologjisë së Ndërtimit të Departamentit të Energjisë në SHBA, kostoja e energjisë për të operuar 5.6 milion ndërtesa tregtare në Shtetet e Bashkuara vlerësohet në 180 miliardë dollarë në vit. Sistemet që ngrohin, ftohin, ajrosin dhe ndriçojnë ndërtesat tona përbëjnë rreth gjysmën e kërkesës për energji në ndërtesa. Ndërsa stoku i ndërtesave në SH.B.A. është pjekur, një gamë e larmishme e teknologjisë është instaluar për të menaxhuar funksionimin e këtyre sistemeve. Industria e automatizimit dhe kontrolleve drejtohej prej kohësh nga prodhues të mëdhenj që ofronin sisteme komplekse dhe të kushtueshme të dizajnuara për të përmbushur nevojat e ndërtesave më të mëdha. Këto sisteme drejtoheshin me arkitekturë pronësore dhe të mbyllur që ishin të shtrenjta dhe komplekse për tu mirëmbajtur. Integrimi nëpër këto sisteme u përmirësua me protokollin e komunikimit të të dhënave të ASHRAE-së BACnet në ndërtesat më të mëdha, por kishte ende vend për inovacione. Kishte mundësi të shkëlqyeshme për zgjidhje me më shumë kosto efektive për menaxhim gjithëpërfshirës të portofoleve të mëdhenj dhe zgjidhje për ndërtesa më të vogla.¹²¹

Rreth 10 vjet më parë, industria e automatizimit dhe kontrolleve pa zhurmën e përçarjes ndërsa Silicon Valley filloi të hidhej në mundësinë për të nxitur efikasitetin e energjisë në ndërtesa përmes softuerit. Në vitet që kanë ndjekur një treg i ri i zgjidhjeve inteligjente të ndërtimit ka lulëzuar. Këto zgjidhje tipizohen nga protokollet e hapura të komunikimit dhe qëllimi i integritit dhe shfrytëzimit të të dhënave nga burime të ndryshme. Analizat e softuerit, ose sistemet e menaxhimit të energjisë së ndërtesës (BEMS), janë thelbi i konceptit inteligjent të ndërtimit. Këto mjete ndihmojnë klientët të fitojnë shikueshmëri në performancën e sistemit brenda një ndërtese të veçantë ose në të gjithë portofolin e tyre. Për më tepër, softueri mund të nxisë përmirësime në ndërtesa të mëdha ose të vogla përmes sistemeve të automatizimit, në mënyrë të pavarur me kontrolle alternative, ose përmes udhëzimeve për përmirësime manuale.¹²²

Tërheqja e tregut e BEMS ka çuar në rritje të shpejtë në treg dhe sipas Navigant Research, të ardhurat në mbarë botën BEMS pritet të rriten nga 2.8 miliardë dollarë në 2016 në 10.8 miliardë dollarë në 2024. Miratimi i gjerë i këtyre zgjidhjeve reflekton kërkesën për më fleksibël zgjidhje të hapura për shfrytëzimin e të dhënave të ndërtesës për përmirësimin e performancës. Sidoqoftë, tregu është dinamik me një

¹²⁰ Ralph, Sisma, 2003, p. 255.

¹²¹ Shrestha, 2007, p. 157.

¹²² Ralph, Sisma, 2003, p. 265.

gamë të gjerë pajisjesh në stokun ekzistues të ndërtesave dhe një bazë të larmishme të konsumatorëve. Në thelb, BEMS siguron transparencë në operacionet e ndërtimit dhe konsumin e energjisë, dhe transformon grupe të ndryshme të të dhënave në informacion të veprueshëm. Pavarësisht nga ndërlikueshmëria në treg, Navigant Research sugjeron që ofertat BEMS mund të vlerësohen kundrejt kategorive të aplikacioneve që variojnë në kompleksitet dhe përfitime.¹²³

BEMS Kanë Përfitime Përtej Efikasitetit të Energjisë. Interneti i Gjërave (IoT) ka të bëjë me komunikimin e sigurt, të shkallëzuar dhe të integruar të të dhënave. Efikasiteti i energjisë është një përfitim i matshëm që shoqërohet me ndryshimet operacionale në sistemet e ndërtimit si ndriçimi dhe HVAC. Kursimet në faturat mujore të shërbimeve ishin tregimi i parë që ofruesit e programeve BEMS prezantuan kur u shfaq tregu. Ndërsa IoT ka çuar në më shumë investime në pajisje në ndërtesa tregtare, shumë përfitime jo-energjetike tani vijnë së bashku me BEMS.¹²⁴

Intel, për shembull, partnerë me ofruesit e BEMS si Lucid për të sjellë IoT në ndërtesa dhe për të rritur përfitimet jo-energjetike të investimeve. Klientët mund të fitojnë dukshmëri dhe transparencë në operacionet e objektit, të menaxhojnë faturat e shërbimeve, të matin ROI me mjete matëse dhe verifikuese, të menaxhojnë buxhetet dhe të planifikojnë shpenzimet kapitale, të përmirësojnë efikasitetin operacional, performancën e ndërtimit standard, të angazhojnë banorët dhe të menaxhojnë faturimin e qiramarrësve. Konvertimi në LED është një hap i parë i rëndësishëm dhe i zgjuar për një arsye shumë të madhe. Ndriçimi dhe kontrolli LED krijojnë kursime të menjëhershme të kostos përmes një reduktimi të konsumit të energjisë. Këto kursime mund të përdoren për të investuar në rrjete të mundësuar nga sensorë dhe një platformë dixhitale në mënyrë që pajisjet dhe sensorët që mbledhin të dhëna të mund të përdorin aplikacione IoT për t'i bërë objektet dhe ndërtesat inteligjente.¹²⁵

3.21. NDRIÇIMI LED DHE RRJETET E MUNDËSUARA NGA SENSORI

Ndriçimi i lidhur po ndryshon mënyrën e funksionimit të bizneseve nëpër industri dhe në të gjithë botën. Unë do të ndaj disa shembuj të fundit nga biznesi ynë.

Një, një kompani teknologjike Silicon Valley me miliarda dollarë instaloi zona të dyfishta të kontrollit të dritës së ditës për të përmirësuar komoditetin e punonjësve dhe kursimet e energjisë. Sensorët e shfrytëzimit kursejnë energji duke ndezur ose fikur dritat bazuar në përdorimin e hapësirës, dhe kontrolli dinamik i ngarkesës së prizës kursen energji kur nuk kërkohen pajisje elektronike. Aftësitë e automatizuara të kërkesës / përgjigjes përputhen me ngjarjet e kërkesës / përgjigjes së shërbimeve

¹²³ Veatch, 2000, p. 125.

¹²⁴ Kleindorfer, 2004, p. 214.

¹²⁵ Lazarat, 2014, p. 2010.

për të kursyer para duke programuar përdorim më të ulët të energjisë kur është në fuqi çmimi maksimal.

Deri më sot, 40 prej ndërtesave dhe parkingjeve të kompanisë janë instaluar me pajisje LED të mundësuar nga kontrollet, duke kursyer kompaninë 70% në kostot vjetore të energjisë, ndërsa punonjësit më të rehatshëm po përmirësojnë prodhimin dhe çojnë biznesin përpara.¹²⁶

Një shembull tjetër, një bankë Fortune 500, zbuloi se 75% e termostateve në vendet e saj të shitjes me pakicë ishin konfiguruar në mënyrë jo të duhur, duke rezultuar në shpenzime dukshëm më të larta të ngrohjes dhe ftohjes. Për më tepër, banka donte të zvogëlonte çështjet e sigurisë për klientët nëse një dritë ATM shuhej natën. Banka instaloi automatizimin e ndriçimit të brendshëm dhe të jashtëm me zbulimin e dështimit, dhe alarme dhe alarme të nivelit të ndërmarrjes. Kontrolli dhe monitorimi i HVAC u instalua gjithashtu për t'u siguruar që termostatët të qëndrojnë në temperaturën e duhur, po punojnë si duhet dhe cilësimet janë të sakta.¹²⁷

Sensorët e njëjtë parashikojnë dështimin e sistemit, duke lejuar caktimin më të mirë të riparimeve dhe shmangien e tarifave të kushtueshme të shërbimit të urgjencës. Informacioni nga këta sensorë gjithashtu mund të përmirësojë operacionet, të zvogëlojë kohën e humbjes dhe të minimizojë ndërprerjet në vendin e punës. Sistemi e bën të lehtë kontrollimin e temperaturës së secilit sit për të përmirësuar komoditetin dhe për të rritur përvojën e klientit në secilën degë. Me më shumë se 400 degë me pakicë, ky biznes po realizon kursime të energjisë dhe operacionale prej gati 1 milion dollarë çdo vit, së bashku me sigurinë e përmirësuar në makineritë e ATM.¹²⁸

Më në fund, një prodhues kryesor i veshjeve atletike po ndërtonte një strukturë të fundit që duhej të sigurote një platformë teknologjike për aplikimet e ardhshme të IoT, të kompensonte kostot operacionale përmes kursimeve të energjisë dhe të sigurote ndriçim të qëndrueshëm në shpërndarjen 1.9 milion metra katrorë qendra. Një rrjet i mundësuar nga Sensori u instalua së bashku me pajisje të reja LED për të siguruar zbulimin e zënies, caktimin dhe akordimin e detyrave. Kompania ka parë një reduktim të energjisë 30% me kombinimin e kontrolleve dhe ndriçimit LED, me një kursim shtesë prej 20% nga akordimi i detyrës. Cilësia e ndriçimit dhe komoditeti i punonjësve po ndikojnë pozitivisht në produktivitetin dhe konsumatori tani po instalon një rrjet të mundësuar nga sensori në një qendër tjetër shpërndarjeje. Unë i ndaj të gjitha këto për të treguar që ndriçimi i lidhur (IoT) është këtu tashmë dhe po ofron një RI të fortë, dhe klientët e të gjitha madhësive, gjeografive dhe industrive mund të përfitojnë sot dhe në të ardhmen duke investuar në këtë teknologji.¹²⁹

¹²⁶ Ralph, Sisma, 2003, p. 244.

¹²⁷ Shrestha, 2007, p. 204.

¹²⁸ Beltran, 2009, p. 88.

¹²⁹ Ralph, Sisma, 2003, p. 274.

3.22. MJEDISËT INTELIGJENTE NË TË ARDHMEN PËR KURSIMITIN E ENERGJIS ELEKTRIKE

Ky është vetëm hapi i parë në rrugën e inteligjencës. Meqenëse rrjeti ynë i mundësuar nga sensori përdor një rrjetë me rrjetë ZigBee, ai ofron fleksibilitetin për të shtuar me lehtësi një larmi pajisjesh dhe sensorë me kalimin e kohës. Me atë fleksibilitet, ai u ofron bizneseve aftësinë për të mbledhur dhe analizuar të dhëna në mënyra të reja dhe nga burime të reja në të ardhmen. Me infrastrukturën në vend, ata mund të përdorin një mori aplikimesh në ekosistem. Për shembull, në zyra, Teem ose iOffice mund të zgjedhin planifikimin e hapësirës dhe të rrisin përdorimin e zonave të përbashkëta; në pakicë, Serraview ndihmon menaxherët të kuptojnë shfrytëzimin e hapësirës në kohë reale dhe të ndjekin modelet e klientëve për një kohë të gjatë; në qendrat e shpërndarjes Keonn menaxhon dhe gjurmon inventarin përmes lexuesve RFID dhe teknologjisë softuerike. Dhe këto janë vetëm disa shembuj të mundësive të mëdha tashmë atje. Ndrëimi i lidhur po e bën të ardhmen më të ndritshme për bizneset kudo, si hapi i parë drejt një ambienti inteligjent.¹³⁰

¹³⁰ Shrestha, 2007, p. 211.

4. GJENDJA AKTUALE E NDËRTESAVE NË KOSOVË DHE EVROPË

4.1 NDËRTESAT NË KOSOVË DHE EVROPË

Rezultatet e Censurit të vitit 2001 treguan se në Kosovë ka rreth 520,936 ndërtesa banimi, që përfshijnë 783,641 banesa deri në prill 2001. Duke u mbështetur në të dhënat nga regjistrimet e vitit 2001 dhe 1989, si dhe ndryshimet e mundshme gjatë viteve 1990, tabela mëposhtë jep një profil të vlerësuar të stokut të banesave, të ndara sipas vitit të ndërtimit¹³¹

Table 2: Vlerësimi i stokut të banesave të ndara sipas vitit të ndërtimit

Para - 1945	215.000	27%
1945 - 1960	80.000	10%
1961 - 1980	230.000	29%
1981 - 1990	140.000	18%
Pas 1991	120.000	15%
TOTAL	785.000	100%

Burimi: Direktiva Europiane për ndërtesat e shërbimeve publike, 2012, p. 25.

Totali i banesave të ndërtuara përgjatë viteve 1945-1989 janë rreth 457,300. Në zonat urbane mbizotëron ndërtimi në formë apartamentesh, ndërsa në zonën rurale vazhdon akoma ndërtimi sipas traditës "të ndërtosh vetë" ku mbizotërojnë ndërtesat familjare tip vile. Rreth 30% të stokut të banesave, dhe më shumë se gjysma e banesave urbane, është i përbërë nga blloqet e apartamenteve të ndërtuara nga shteti gjatë periudhës së komunizmit, kur sektori publik prodhonte një produkt pa standarde energjitike dhe me hapësira të kufizuara. Në fazat e hershme u ndërtuan pallate me pak kate, dhe nga 1970 u përdor në shkallë të gjerë ndërtimi i pallateve parafabrikate. Pallate gjashtë-katëshe janë ndërtuar nga mesi i viteve 1960 e më pas (pallate me ashensorë dhe më të larta se gjashtë kate nuk ndërtoheshin). Qeveria e atëhershme, gjatë 1977-1988, lejonte apartamente me 61,7 m² të sipërfaqes së përdorshme për 4-5 persona, plus 19.5 m² për shkallët, mure, etj, me projekte prototip të përgatitura nga Instituti Kombëtar i Studimeve dhe Projektimeve.¹³²

Gjatë periudhës 2003-2008, ndërtimi pati një rritje dyshifrore përsa i përket vlerës së shtuar, i mbështetur nga vala e madhe e lejeve të miratuara për ndërtime private,

¹³¹ Krasniqi, 2014, p. 47.


¹³² Beltran, 2009, p. 90.

kërkesa e lartë për strehim, lëvizjet dinamike demografike, si dhe një klimë e favorshme për financime mbështetëse.¹³³

Rritja vjetore e këtij sektori gjatë kësaj periudhe ka qenë 10-15%, duke e kthyer ndërtimin në sektorin më të zhvilluar. Pas vitit 2008, tkurrja e lejeve të ndërtimit e ngadalësoi këtë sektor. Duke filluar nga gjysma e dytë e vitit 2009, veprimtaria në sektorin e ndërtimit ra ndjeshëm (mes. 22,5% në vitin 2010). Pas një tkurrije të fortë gjatë vitit 2012, sektori i ndërtimit shënoi një rritje të përkohëshme në tremujorin e dytë të vitit 2013, kryesisht të lidhur me investimet publike. Pavarësisht rritjes fillestare në këtë sektor, përqëndrimi shumë i madh i ndërtesave në disa territore konfirmoi mungesën e vazhdueshme të vizionit të zhvillimit urban dhe mungesën e vizionit për ndërtesa cilësore në drejtim të konfortit dhe konsumit të energjisë.¹³⁴

Sipas Censurit të vitit 2011 ndërtesat në Kosovë klasifikohen sipas katër kategorive: i) Shtëpi individuale; ii) Shtëpi pjesërisht e veçuar; iii) Shtëpi në rend ose tarracore; iv) Pallate. Ndërsa numri i banesave për ndërtesë, për të cilat janë mbledhur të dhëna, varion duke filluar nga 1, 2, 3-4, 5-8, 9-15, dhe më shumë se 16. Në vitin 2011 rezultoi sipas censurit se në Kosovë ka 598.267 ndërtesa në total, rreth 84% të të cilave janë ndërtesa individuale. Ndarë sipas vitit të ndërtimit, si ndërtesat dhe banesat rezidenciale janë rritur në mënyrë eksponeciale.¹³⁵

Figure 2: Ndarja e ndërtesave sipas kategorive, prefekturave dhe në total



Burimi: Efienca e Energjisë në ndërtesa” – Shërbimet e konsulencës së IFC (International), 2015. p. 90.

Gjithashtu deri në vitin 1960 në Kosovë ka patur 279.805 banesa (ose 27.6%), ndërkohë që sipas censurit 2011, deri në këtë vit kishte 1.012.062 banesa. Pra përgjatë 50-vjeçarit, 1961-2011 numri i ndërtesave është rritur me 8 herë, ndërkohë që numri i banesave është rritur me pothuaj 4 herë.¹³⁶


¹³³ Krasniqi, 2014, p. 48.

¹³⁴ Instituti i Energjis - Updated Capital Cost Estimates for Utility Scale Electricity Generating Plants. Energy Information Administration

¹³⁵ Beltran, 2009, p. 91.

¹³⁶ Tidball, 2010, p. 133.

Figure 3: Ndërtesa dhe banesa akumulative sipas vitit të ndërtimit në rang vendi



Burimi: Eficienca e Energjisë në ndërtesa” – Shërbimet e konsulencës së IFC (International), 2015. p. 91.

Në bazë të të dhënave të Eurostat, për vitin 2000, Gjermania kryeson listën e vendeve Evropiane përsa i përket numrit të banesave me rreth 38,4 milion banesa. Ndërsa përsa i përket indeksit të banesave për 1000 banorë, kryeson Greqia me 500 banesa/1000banorë, pasuar nga Franca dhe Finlanda me 94 banesa/1000banorë dhe më pas Suedia me 483 banesa/1000banorë.¹³⁷


4.2. KONSUMI I ENERGJIS NË NDËRTESEA

Përsa i përket konsumit të energjisë finale në sektorin rezidencial, në bazë të të dhënave të Eurostat, për vitin 2000, Gjermania, e cila ka numrin më të lartë të banesave në EU-27, rezulton të jetë gjithashtu me konsumin më të lartë energjistik me rreth 65,2 [Mtoe]. Të vetmet vende të EU-27 që nuk rezultojnë me konsum më të lartë energjistik në sektorin rezidencial sesa Kosova janë Malta dhe Qipro.¹³⁸

¹³⁷ Beltran, 2009, p. 92.

¹³⁸ Ibid.

Figure 4: Konsumi final i energjisë në sektorin rezidencial dhe numri i banesave për EU-27 & AL, viti 2000



Burimi: Eficienca e Energjisë në ndërtesa” – Shërbimet e konsulencës së IFC (International), 2015, p.110.

Ndërkohë për vitin 2000, indeksi i konsumit final të energjisë për vendet e EU-27 & Kosovën tregon se Kosova ka indeksin më të ulët të konsumit energjistik, vetëm 0.12 [toe/banorë] ose 1'395 [kWh/banorë], ndjekur nga Malta, Qipro, Bullgaria, Portugalia dhe Spanja, Një pjesë të mirë të konsumit të energjisë në sektorin rezidencial e zë energjia elektrike. Bazuar në të dhënat e raporteve vjetore të ERE, për vitin 2011, 2012, 2013 janë paraqitur në mënyrë grafike prodhimi, konsumi, importi dhe eksporti i energjisë elektrike për periudhën 1985-2013. Që prej vitit 1998, Kosova rezulton të jetë një importuese totale e energjisë elektrike, edhe pshenë vitet në vitet më pas, për shkak të ndërprejeve të energjisë elektrike konsumi nuk përfaqson kërkesën reale. Që prej vitit 1998, Kosova ka eksportuar energji elektrike vetëm në vitin 2010, vit i cili ka qenë shumë i lagësht Importi i energjisë elektrike i ka kushtuar jo pak shqiptarëve. Të vendosura në një grafik, importi, kosto e tij dhe çmimi mesatar, pamja për periudhën 2002-2013 do ishte sipas grafikut më sipër. Kosto mesatare vjetore e importit të energjisë elektrike për periudhën 2002-2013 ka qenë 96,07 Milion Euro/vitDuke konsideruar vitin 2008 si vitin e kthesës përse i përket ndërprerjeve të energjisë elektrike, vit pas të cilit ndërprerjet kanë qenë të neglizhueshme, shohim një trend rritës në konsumin e energjisë elektrike, në vitet 2009-2013.¹³⁹

¹³⁹ Tidball, 2010, p. 140.

4.3. MASAT E EFIÇIENCËS DHE KONSUMI I ENERGJIS ELEKTRIKE

Sipas statistikave të viteve të fundit të konsumit të Energjisë dhe Energjisë elektrike në Kosovë, konsumi i energjisë shkon për këto gjashtë shërbime: 1) Ngrohje; 2) Freskim; 3) Ujë të ngrohtë; 4) Gatim; 5) Pajisje elektrike, 6) Ndriçim, sipas përqindjeve të mëposhtme

Konsumi në rritje i energjisë totale dhe i energjisë elektrike për shkak të rritjes së konfortit të kërkuar por njëkokësisht edhe rritja e çmimit të komoditeve energjitike, ka sjellë rritjen e përdorimit të masave të Eficencës së Energjisë (EE) dhe përdorimin e Burimeve të Rinovueshme të Energjisë (BRE) në banesa. Më poshtë po listojmë një sërë masash të mundshme EE dhe BRE për t'u aplikuar në banesa të cilat ndahen në masa që reduktojnë kërkesën për energji dhe masa për plotësimin e kërkesës së mbetur për energji në mënyrë sa më efiçente.¹⁴⁰

Termoizolimi: Termoizolimi i pareteve të jashtme është një nga masat e EE më të njohura dhe më të përdorshme në banesa. Një banesë e termoizoluar rezulton të ketë një kërkesë për ngrohje/freskim shumë më të reduktuar sesa një banesë jo e termoizoluar. Ajo çfarë edhe është më e rëndësishme, në banesat e termoizoluara, temperatura sipërfaqore e mureve të brendshme si dhe temperatura e brendshme e mjediseve që nuk ngrohen rezulton të jetë shumë më e lartë sesa në rastet pa termoizolim. Aplikimi i termoizolimit, në mënyrën e duhur, shmang gjithashtu problemet me kondensimin e avujve të ujit përgjatë nëpër strukturat e ndërtimit.¹⁴¹

Dritare me koeficient transmetimi të ulët: Dritaret janë një nyje termike e domosdoshme në një banesë pasi plotësojnë kushtin e ndriçimit natural të nevojshëm për një banesë, mirëpo tradita e trashëguar e përdorimit të dritareve me koeficient të ulët transmetimi rrit së pari humbjet/fitimet termike dhe së dyti rrit efektin e nyjeve termike ndërmjet mureve dhe dritareve. Prandaj instalimi i dritareve me koeficient të ulët transmetimi ndikon ndjeshëm në reduktimin e humbjeve/fitimeve termike. Tendenca aktuale është që në rastet e përdorimit të dritareve me koeficient të ulët transmetimi, përdoret dopja xham ose edhe xham tresh ndonjëherë, dhe njëri prej xhamave është xham termik, për t' shmangur sa më shumë përfitimet termike gjatë verës.¹⁴²

Hijezimet dhe grilat: Në fasadat e orientuara drejt Lindjes, Jugut dhe Perëndimit kemi një rritje të ngarkesës termike në verë për shkak të rrezatimit diellor. Përdorimi i hijezimeve apo grilave bën të mundur reduktimin e ngarkesës termike në verë. Duhet theksuar që hijezimi duhet bërë i tillë që të shmang rrezatimin diellor në verë (kur dielli qëndron në një kënd të lartë me horizontin) por lejon rrezatimin diellor përgjatë dimrit (kur kur dielli qëndron në një kënd të ulët me horizontin). Përveç hijezimit dhe grilave, në shtëpitë e veçuara, ku mund të jetë edhe më e mundshme,

¹⁴⁰ Toth, 2000, p. 315.

¹⁴¹ Tidball, 2010, p. 141.

¹⁴² Toth, 2000, p. 316.

rekomandohet mbjellja e pemëve të cilat i rrëzojnë gjethet gjatë stinës së dimrit në lindje, jug dhe perëndim.¹⁴³

Ndriçim eficient: Edhe pse ndriçimi në tortën e konsumit të energjisë është zëri më i ulët sërish masa të EE mund të sjellin reduktim të konsumit për ndriçim i) duke futur llamba me konsum të ulët LED ose llamba ekonomike ose atje ku është e mundur ndriçim fluoreshent; ii) duke futur komandim të veçuar të ndriçuesve apo komandim me lëvizje atje ku është e mundur; iii) duke eliminuar ndriçues të jashtëm të panevojshëm dhe duke i zëvenduar ato me ndriçim fotovoltaiik.¹⁴⁴

Pajisje elektrike eficiente: Në banesat tona përdorim shumë pajisje elektrike për të siguruar komoditet, konfort dhe kënaqësi. Disa prej tyre janë: lavatriçe, lavastovilje, frigorifer, hekur për hekurosje, fshesë elektrike, tharëse flokësh, furrë me mikrovalë, TV, kompjuter, laptop, magnetofon, play-station, karikues të ndryshëm, ekspres kafeje, brumatriçe elektrike, thekëse buke, tostër, jastëk e jorgan termoelektrikë, ventilator, etj. Edhe pse secila prej tyre më vete mund të ketë një konsum të ulët, pajisjet elektrike përbëjnë rreth 16% të konsumit të energjisë elektrike në sektorin rezidencial prandaj është e rekomandueshme përdorimi i pajisjeve elektrike të tipit A, A+ apo A++, për të reduktuar konsumin e ardhur prej tyre.¹⁴⁵

Pajisje gatimi eficiente: në pajisjet e gatimit përfshihen furrat (që potuaj janë 100% me energji elektrike), aspiratorët, pianurat, sobat me gaz apo sobat me dru që përdoren akoma në zonat rurale. Pajisjet e gatimit elektrike përbëjnë rreth 12% të konsumit të energjisë elektrike në sektorin rezidencial prandaj është e rekomandueshme përdorimi i pajisjeve elektrike të tipit A, A+ apo A++, për të reduktuar konsumin e ardhur prej tyre.¹⁴⁶

Pajisje elektrike eficiente për ngrohje/freskim: Nëse freskimi kryhet vetëm me energji elektrike me pompa nxehtësie (kondicioner ose chiller), ngrohja e banesave përveçse me energji elektrike mund të jetë edhe me dru zjarri, pelet, dizel apo GNL. Konsumi mesatar për ngrohje/freskim në sektorin rezidencial shkon mesatarisht rreth 46,5% të energjisë totale ose 36,5% e energjisë elektrike. Nisur nga pesha e lartë e tyre në konsum, është e domosdoshme reduktimi në maksimum i ngarkesave termike në dimër/verë dhe për ngarkesën e reduktuar kalimi në përdorimin e pajisjeve më eficiente si kondicioner split inverter, kondicioner multisplit inverter apo pompë nxehtësie ajër-ujë të cilat paraqesin një KIP të lartë në përdorimin e tyre. Sigurisht që në zonat që nuk kanë nevojë për freskim mund të ishte me vend edhe përdorimi i oxhaqeve me dru me çark hidronik apo kaldaja/termostufa me pelet që shpeshherë mund të rezultojnë në zgjidhjen më optimale.¹⁴⁷

¹⁴³ Tidball, 2010, p. 142.

¹⁴⁴ Toth, 2000, p. 357.

¹⁴⁵ Dataset Crude oil Area exchange, 2013, p. 37.


¹⁴⁶ Ibid.

¹⁴⁷ Markowitz, 1951, p. 40.

Pajisje efçente për sigurimin e ujit të ngrohtë: Në përgjithësi uji i ngrohtë në familjet shqiptare sigurohet me bojler elektrik, në zonat rurale shpesh edhe me dru dhe në objektet me sistem të integruar të ngrohje/freskimit mund të sigurohet edhe prej pajisjeve të përdorura për ngrohje/freskim. Megjithatë në raste të një konsumi të konsiderueshëm, ujë i ngrohtë mund të sigurohet edhe me kolektorë diellor apo kolektorë diellor me cikël termodinamik, zgjidhje që shpesh rezultojnë me kosto ekonomike. Me kalimin e kohës, që prej vitit 1950, projektimi i sistemeve HVAC ka ardhur duke u përmirësuar por gjithashtu edhe konsumi i energjisë është rritur. Ky trend është përmbysur me futjen e sistemeve më efikase dhe duke kryer termoizolim të objekteve të ndërtimit. Nivelet e komfortit janë rritur në mënyrë të vazhdueshme, dhe kostot e sistemit kanë filluar të bien me futjen e teknikave më të mira dhe teknologjive të reja.¹⁴⁸

Grafiku i mëposhtëm tregon ndryshimet në zarin e ndërtesave të banimit që nga viti 1950. Deri në mesin e shekullit XX, shumica e shtëpive kishin ngrohje qendrore. Në atë kohë, roli i të paturit një rezistencë termike të lartë dhe një hermetizim të mirë të ndërtesës në konfort dhe kosto të ulët konsumi energjie nuk është kuptuar siç duhet. Me rritjen e termoizolimit dhe hermetizimit, u rrit ndjeshëm niveli i konfortit dhe u reduktua konsumi i energjisë.¹⁴⁹

Figure 5: Ndryshimet në zarin e ndërtesave të banimit që nga viti 1950



Burimi: Efçienca e Energjisë në ndërtesa” – Shërbimet e konsulencës së IFC (International), 2015, p.122.

¹⁴⁸ Dataset Crude oil Area exchange, 2013, p. 39.

¹⁴⁹ Markowitz, 1951, p. 47.

4.4. PËRSHKRIMI I NDËRTESAVE, SKICIMI DHE TË DHËNAT TERMIKE

Objekti I: Siç kemi cekur më lartë ndërtesat i takojnë grupit të konsumuesve më të mëdhenj të energjisë si për ngrohje dhe asaj elektrike. Për këtë arsye nevojiten të bëhen plane, kërkime dhe veprime për të përmirësuar performancën energjetike të këtyre ndërtesave. Në fazën e zhvillimit të planit të efijencës së energjisë është e nevojshme që të identifikohen në detaje karakteristikat e ndërtesës siç janë: lokacioni, lloji, vjetërsia, gjendja teknike, izolimi, hapësira, cilësia e materialit ndërtimor dhe burimi i ngrohjes. Në këtë punim diplome do të bëhet analizimi i një objekti privat dhe një ndërtese publike për të treguar se si mund të përmirësohet Efijenca Energjetike duke përdorur termoizolim. Në këto objekte do të llogariten humbjet termike në rastin konkret gjendja faktike e objektit si dhe në rastin kur në të është aplikuar termoizolimi.

Objekti i parë i marrë në studim është një objekt banimi që ndodhet në rajonin e Prishtinës me të dhëna si vijon:¹⁵⁰

Figure 6: Planimetria e objektit privat




Burimi: Efijenca e Energjisë në ndërtesa” – Shërbimet e konsulencës së IFC (International), 2015, p.128.

¹⁵⁰ Shrestha, 2007, p. 120.

Objekti është shtëpi banimi me sipërfaqe 77 m² e ndërtuar në vitet e '80-ta me lartësi të katit 2.8 m. - Muret e jashtme: me trashësi 27 cm pa izolim, me sipërfaqe 33.78 m² duke mos llogaritur hapësirën e dritareve,

- o Tullë = 25 cm,
- o Suvatim Ilaç – vazhdues (çimento, gëlqere, rërë dhe ujë) = 2 cm,

Figure 7: Prerja e murit të objektit




Burimi: Efiçienca e Energjisë në ndërtesa” – Shërbimet e konsulencës së IFC (International), 2015, p.141.

Pllaka mbi tokë:

- o Beton – arme (20 cm) = 77 m²,
- o Zhavorr (30 cm) = 77 m²,
- Dyshemeja – është nga pllaka beton-arme ku mbi të janë të vendosura shtresa të ndryshme:
 - o Qeramikë (1 cm) = 4.15 m²,
 - o Parket (2 cm) = 72.85 m²,
 - o Nivelizim (5 cm) = 77 m²,¹⁵¹

¹⁵¹ Efiçienca e Energjisë në ndërtesa” – Shërbimet e konsulencës së IFC (International), 2015, p.141.

Figure 8: Pllaka mbi tokë



Burimi: Efiçienca e Energjisë në ndërtesa” – Shërbimet e konsulencës së IFC (International), 2015, p.144.

Dyert dhe dritaret në muret e jashtme:

Dyert e jashtme me material nga druri me xham izolues (HA 6 deri në 8 mm),

Dritaret – me kornizë druri dhe xham izolues (HA 8 deri në 10 mm),

Tavani:

Beton – arme = 20 cm,

Suvatim llaç – vazhdues = 2 cm,

Kulmi:

Është nga konstruksioni i drurit e mbuluar me tjegulla dhe nuk ka izolim¹⁵²

¹⁵² Efiçienca e Energjisë në ndërtesa” – Shërbimet e konsulencës së IFC (International), 2015, p.141.

5. NDIKIMI I NDËRTESAVE INTELIGJENTE NË EE.

5.1. KAPACITETI TERMIK I KALDAJËS DHE RADIATORËVE TË INSTALUAR

Sistemi i ngrohjes i instaluar në këtë ndërtesë banimi për ngrohje përdorë rrymën elektrike. Kaldaja e instaluar është me kapacitet 12 kW. Sistemi për shpërndarje të nxehtësisë ka një linjë shpërndarëse ku është e vendosur pompa. Uji i ngrohtë sanitar merret nga bojleri me kapacitet prej 80 litra i cili po ashtu ngrohet me rrymë elektrike. Radiatorët janë të tipit Panel në gjendje të mirë me kapacitet të instaluar si vijon:¹⁵³

Table 3: Kapaciteti i instaluar i trupave ngrohës (radiatorëve)

Tipi i radiatorit	Gjerësia (mm)	Lartësia (mm)	Gjatësia (mm)	Kapaciteti 90/70°C (W)	Sasia (copë)	Kapaciteti i total (W)
TIP – 22	22	600	1400	3126	1	3126
TIP – 22	22	600	1000	2236	3	4472
TIP – 22	22	600	800	1791	1	1791
TIP – 22	22	600	600	1346	1	1346
TIP – 22	22	600	500	1124	1	1124
Kapaciteti total i instaluar (W)						11859

Burimi: Eficienca e Energjisë në ndërtesa” – Shërbimet e konsulencës së IFC (International), 2015, p.151.

Kapaciteti i instaluar i radiatorëve është 11.8 (kW) kurse kaldaja e instaluar ka kapacitet 12 (kW). Fuqia termike e kaldajës në dalje (fuqia e dobishme) mund të llogaritet sipas shprehjes: $Q = P \cdot \eta_{kaldajës}$ Ku: P – fuqia, $\eta_{kaldajës}$ – eficienca e kaldajës. Meqenëse gjendja e kaldajës është relativisht e mirë konsiderojmë se ajo punon me efikasitet prej 75%.¹⁵⁴

5.2. KOEFICIENTI I TRANSMETIMIT PËR KOMPONENTËT E MBËSHTJELLËSIT TË NDËRTESESË

Humbjet e nxehtësisë nëpër mbështjellësin e ndërtesës (muret e jashtme) si dhe humbjet në infiltrim janë madhësitë kryesore për përcaktimin e ngarkesës ngrohëse të një objekti. Meqë në këtë rast dihet kapaciteti i kaldajës dhe duke konsideruar që

¹⁵³ Roli i burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe eficienca në zhvillimin ekonomik të Komunave, 2014, p. 67.

¹⁵⁴ Ibid.

kapaciteti i kaldajës i përgjigjet ngarkesës ngrohëse për objektin, në vazhdim do të prezantohet vetëm kalkulimi i koeficientit të transmetimit të nxehtësisë i cili më vonë do të shfrytëzohet për llogaritjen e energjisë së konsumuar vjetore për mbulimin e humbjeve nga çdo pjesë përbërëse e mbështjellësit të ndërtesës.¹⁵⁵ Kalkulimet e humbjeve në murin e jashtëm për gjendjen faktike të ndërtesës llogariten sipas formulave të poshtëshënuara rezultatet e të cilave do t'i paraqesim në formë tabelare:

Table 4: U-vlerat për murin e jashtëm para masave EE

Muret e jashtme (25 cm) – 33.78 m²					
	Materiali	Dendësia (kg/m³)	Trashësia e materialit	Koeficienti i përçueshmërisë termike	Rezistenca termike
			d (m)	λ (W/mK)	R = d / λ (m²K/W)
1	Tullë	1200	0.25	0.50	0.5
2	Suvatim – Ilaç	1800	0.02	0.87	0.023
ΣR (m²K/W)					0.523
Rezistenca termike e sipërfaqes së brendshme – R _b					0.13
Rezistenca termike e sipërfaqes së jashtme – R _j					0.04
Rezistenca e përgjithshme termike: R _T = R _b + ΔR + R _j (m ² K/W)					0.693
Koeficienti i transmetimit të nxehtësisë: U = 1 / R _T (W/m ² K)					1.443

Burimi: Eficienca e Energjisë në ndërtesa” – Shërbimet e konsulencës së IFC (International), 2015, p.159.

Ku: U – koeficienti i tejkalimit të nxehtësisë (W/m²K),

R_b – rezistenca e transmetimit termik të sipërfaqes së brendshme (m²K/W),

R – Rezistenca termike e materialit (m²K/W),

R_j – rezistenca e transmetimit termik të sipërfaqes së jashtme (m²K/W),

d – trashësia e mureve (m),

λ – koeficienti i përçueshmërisë termike (W/mK).

¹⁵⁵ Krasniqi, 2014, p. 79.

Table 5: U-Vlerat për dysheme para masave EE

Dyshemeja (57 cm) – 77 m²					
	Materiali	Dendësia (kg/m³)	Trashësia e materialit	Koeficienti i përçueshmërisë ë termike	Rezistenca termike
			d (m)	λ (W/mK)	R = d / λ (m²K/W)
1	Beton – arme	2400	0.20	2.1	0.095
2	Zhavorr		0.30	1.5	0.2
3	Nivelizim	2200	0.05	1.65	0.03
4	Parket	800	0.02	0.20	0.1
ΣR (m²K/W)					0.425
Rezistenca termike e sipërfaqes së brendshme – R _b					0.13
Rezistenca termike e sipërfaqes së jashtme – R _j					0.04
Rezistenca e përgjithshme termike: R _T = R _b + ΔR + R _j (m ² K/W)					0.595
Koeficienti i transmetimit të nxehtësisë: U = 1 / R _T (W/m ² K)					1.680

Eficienca e Energjisë në ndërtesa” – Shërbimet e konsulcës së IFC (International), 2015, p.161.

Table 6: U-Vlerat për pllakën e kulmit para masave EE

Kulmi/tavani					
	Materiali	Dendësia (kg/m³)	Trashësia e materialit	Koeficienti i përçueshmërisë ë Termike	Rezistenca termike
			d (m)	λ (W/mK)	R = d / λ (m²K/W)
1	Beton – arme	2400	0.20	0.64	0.313

2	Suvatim – Ilaç Vazhdues	1800	0.02	0.87	0.023
ΣR (m²K/W)					0.335
Rezistenca termike e sipërfaqes së brendshme – R _b					0.13
Rezistenca termike e sipërfaqes së jashtme – R _j					0.04
Rezistenca e përgjithshme termike: R _T = R _b + ΔR + R _j (m ² K/W)					0.505
Koeficienti i transmetimit të nxehtësisë: U = 1 / R _T (W/m ² K)					1.980

Efiçienca e Energjisë në ndërtesa” – Shërbimet e konsulencës së IFC (International), 2015, p.165.

Rezistenca termike për dyer të jashtme me kornizë druri dhe xham izolues (HA 6 deri në 8 mm) është: U = 3.5 (W/m²K),

Kurse rezistenca termike për dritare me kornizë druri dhe xham izolues (HA 8 deri në 10 mm), është: U = 3.2 (W/m²K)¹⁵⁶

Konsumi specifik energjetik vjetor

Kërkesa vjetore për ngrohje Q (kWh/vit), është shuma e llogaritur energjisë që sistemi i ngrohjes duhet të furnizojë ndërtesën gjatë vitit për të ruajtur temperaturën e brendshme të projektuar. Kjo energji vjetore, e llogaritur për ngrohje, nuk duhet të jetë më e lartë se ajo e kërkuar me “Rregulloren teknike për kursim të energjisë”.

Llogaritja e konsumit specifik energjetik vjetor bëhet në baza mujore, orë pune, gradë ditore, rezistenca dhe temperaturë mesatare duke u bazuar në të dhëna atmosferike të regjionit në të cilin gjendet ndërtesa.

Për përcaktimin e gradëve ditore së pari duhet të dihet temperatura mesatare e ajrit të jashtëm në periudhën e ngrohjes që përcaktohet me ndihmën e temperaturave mesatare për të gjitha ditët që i takojnë periudhës së ngrohjes.¹⁵⁷

Sipas “Rregullores teknike për kursimin e energjisë” për rajonin e Prishtinës faza e ngrohjes fillon nga data 15 Tetor dhe përfundon me 15 Prill. Temperatura e jashtme mesatare për muajin Tetor është 10.63 °C, për muajin Nëntor 6.41 °C, për muajin Dhjetor 1.72 °C, për muajin Janar -0.56 °C, për muajin Shkurt 1.77 °C, për muajin Mars 5.40 °C dhe për muajin Prill 10.70 °C. Këto temperatura janë përfutuar duke bërë matjet në ora 7, 14 dhe 21 prej nga na del temperatura mesatare mujore. P. Sh. për muajin Janar kemi:

$$t_{janar} \square t_{md,1} \square t_{md,2} \square \dots \square t_{md,31}$$

¹⁵⁶ Ralph, Simsa, 2003, p. 51.

¹⁵⁷ Krasniqi, 2014, p. 94.

$t_{md,1}, t_{md,2} \dots t_{md,31}$ – janë temperaturat mesatare ditore për çdo ditë të muajit Janar,

t_{janar} - është temperatura mesatare mujore e muajit Janar.¹⁵⁸

Prandaj në bazë të shënimeve të cekura më lartë për temperaturën mesatare mujore për rajonin e Prishtinës, gradët ditore për muajt e ngrohjes llogariten si vijon:

$GD = (t_{mb} - t_{mj}) \times \text{ditët e muajit}$

Pra, për muajin Tetor: $GD = (20 - 10.63) \times 15 = 140.55$,

Nëntor: $GD = (20 - 6.41) \times 30 = 407.7$,

Dhjetor: $GD = (20 - 1.72) \times 31 = 566.68$,

Janar: $GD = (20 + 0.56) \times 31 = 637.36$,

Shkurt: $GD = (20 - 1.77) \times 28 = 510.44$,

Mars: $GD = (20 - 5.40) \times 31 = 452.6$,

Prill: $GD = (20 - 10.70) \times 15 = 139.5$.

Ndryshimi i temperaturës Δt , sipas kriterëve që aplikohen tek ne, për kushtet kur temperatura mesatare e ajrit në objektin që ngrohet është $t_{bm} = 20$ °C, kurse fillimi dhe mbarimi i ngrohjes duhet bërë për temperaturën mesatare të ajrit të jashtëm $t_{jm} = -18$ °C.¹⁵⁹

Table 7: Shpenzimi i energjisë për ngrohje për murin e jashtëm para masave EE

Kalkulimi i gjendjes faktike të ndërtesës								
Orët e operimit (h/ditë)						16	Humbjet e nxehtësisë/ngarke sa për ngrohje	
Muret e jashtme				33.78 (m²)		24		
Nr.	Periudha e ngrohjes	T_{mj}	Ditë	GD	U	Δt	Q_t	E_n
		(°C)			(W/m²K)	(°C)	(kW)	(kWh/vit)
1	Tetor	10.63	15	140.55	1.443	9.37	0.46	40.81
2	Nëntor	6.41	30	407.70	1.443	13.59	0.67	171.69
3	Dhjetor	1.72	31	566.68	1.443	18.28	0.90	320.99
4	Janar	-0.56	31	637.36	1.443	20.56	1.01	406.05
5	Shkurt	1.77	28	510.44	1.443	18.23	0.89	288.34

¹⁵⁸ Ralph, Simsa, 2003, p. 52.

¹⁵⁹ Veatch, 2000, p. 208.

6	Mars	5.4	31	452.60	1.443	14.60	0.72	204.76
7	Prill	10.7	15	139.50	1.443	9.30	0.46	40.20
Totali i shpenzimit të energjisë për ngrohje (kWh)								1,472.83

Efiçienca e Energjisë në ndërtesa” – Shërbimet e konsulencës së IFC (International), 2015, p.171.

Table 8: Shpenzimi i energjisë për ngrohje për dritare para masave EE

Kalkulimi i gjendjes faktike të ndërtesës								
Orët e operimit (h/ditë)						16	Humbjet e nxehtësisë/ngarke sa për ngrohje	
Dritare me kornizë druri				17.12 (m²)		24		
Nr.	Periudha e ngrohjes	T_{mj}	Ditë	GD	U	Δt	Q_t	E_n
		(°C)			(W/m²K)	(°C)	(kW)	(kWh/vit)
1	Tetor	10.63	15	140.55	3.200	9.37	0.51	45.57
2	Nëntor	6.41	30	407.70	3.200	13.59	0.74	191.71
3	Dhjetor	1.72	31	566.68	3.200	18.28	1.00	358.42
4	Janar	-0.56	31	637.36	3.200	20.56	1.13	453.41
5	Shkurt	1.77	28	510.44	3.200	18.23	1.00	321.97
6	Mars	5.4	31	452.60	3.200	14.60	0.80	228.64
7	Prill	10.7	15	139.50	3.200	9.30	0.51	44.89
Totali i shpenzimit të energjisë për ngrohje (kWh)								1,644.60

Efiçienca e Energjisë në ndërtesa” – Shërbimet e konsulencës së IFC (International), 2015, p.176.

Konsumi specifik energjetik vjetor për m² për dritare me kornizë druri është: 1,644.60 (kWh/vit) / 17.12 (m²) = 96.06 (kWh/m²/vit).

Duke u bazuar në tarifën për energji elektrike që aplikohet në Republikën e Kosovës del se çmimi mesatar për kWh është 0.055 Euro. Kjo vlerë është llogaritur duke marrë parasysh tarifën e lartë e cila aplikohet për 15 orë në ditë me çmim 0.07 cent si dhe tarifa e ultë me çmim 0.03 cent për 9 orët tjera.

Kështu kostoja e shpenzimit për ngrohje në objektin e banimit të shqyrtuar me këtë rast del se është rreth 635.10 Euro/vit apo 19.31 Euro për m²/vit. Kjo vlerë e përcakton energjinë elektrike të shpenzuar vetëm për ngrohje për periudhën kur fillon

sezoni i ngrohjes Tetor – Prill, dhe atë me temperaturë mesatare të ambientit 20 °C.¹⁶⁰

Sipas trendit financiar, duke u fokusuar në analizat e bëra nga Zyra e Rregullatorit për Energji pritet që për 20 vitet e ardhshme çmimi i energjisë elektrike të ngritet për 5% që do të thotë që deri në vitin 2038 çmimi për kWh parashikohet se do t'a arrij vlerën për rreth 0.30 (Euro/kWh). Prandaj duke u bazuar në këtë trend të ngritjes së çmimeve vlen të theksohet se nevoja për investim në Efiçencë të Energjisë do të jetë gjithnjë e më e nevojshme.¹⁶¹

